



Kingdom of the Netherlands



RAPORT STUDIMOR

Promovimi i mirëkuptimit,
tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri

2019





Kingdom of the Netherlands



2019

RAPORT STUDIMOR

Promovimi i mirëkuptimit,
tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit "Promovimi i mirëkuptimit, tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri", mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta.

Përbajtja e këtij rapporti është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin e ekspertëve të angazhuar në këtë punim, apo qëndrimin e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë.

► *Eksperti i angazhuar për punimin e raportit:*

Prof. Asoc. Dr. Enri Hide, ekspert i jashtëm, KShH

► *Rishikoi raportin:*

Prof. Asoc. Dr. Aurela Anastasi, eksperte e jashtme, KShH

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për autorin.

Asnjë pjesë e këtij teksti nuk mund të riprodhohet pa lejen apo citimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Nëse jeni të interesuar për këtë report, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII, Pallati "TeknoProjekt" Shk. 2, Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia postare nr.1752

Tel.: +355 4 2233671; Cel.: +355 682023699

<https://www.facebook.com/KomitetishqiptariHelsinki>

E-mail: office@ahc.org.al;

www.ahc.org.al



PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4 |
| METODOLOGJIA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE | 5 |
| I. KONTEKSTI HISTORIK I HARMONISË DHE BASHKEKZISTENCËS FETARE NË SHQIPËRI | 8 |
| II. LIRIA E BESIMIT MES TË RINJVE NË FAMILJE DHE KOMUNITET | 15 |
| III. EDUKIMI MBI LIRITË FETARE NË SHKOLLA | 27 |
| IV. RADIKALIZIMI DHE EKSTREMIZMI MIDIS TË RINJVE | 35 |
| V. GJETJE, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME | 39 |
| BIBLIOGRAFIA | 42 |
| ANEKS | 45 |
| I. LISTA E TË INTERVISTUARVE | |
| II. ANKETA | |

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim është realizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në kuadër të nismës "Promovimi i mirëkuptimit, tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri", mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri. Ai ka qëllim të hulumtojë lirinë e besimit, harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfetare, si vlera themelore të shoqërisë shqiptare dhe rolin e tyre mes të rindjeve, si një instrument për parandalimin e përhapjes së ideologjive ekstremiste.

Ky studim është bazuar në një literaturë të gjërë të çështjes së harmonisë ndërfetare në Shqipëri, si dhe në hulumtimin e dimensioneve të lirisë fetare në vendet demokratike perëndimore, duke përfshirë në një dimension krahasimor Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor.

Nga pikëpamja metodologjike, studimi bazohet në një anketim të gjërë me të rindjtë e moshës 15-35 vjeç (me shtrirje kombëtare) mbi vlerat e lirisë së besimit tek kjo kategori. Analiza pasurohet nga intervistat e thelluara me aktorë kyçë institucionalë dhe publikë, përfaqësues të fesë dhe të arsimit, për të kuptuar perceptimin dhe rolin e tyre lidhur me lirinë e besimit fetar tek të rindjtë. Të rindjtë përbëjnë një ndër variablat më të rëndësishme të modelit të harmonisë ndërfetare të shoqërisë shqiptare, pasi ata mund të kontribuojnë jo vetëm në qëndrueshmérinë e këtij modeli në të ardhmen, por edhe për promovimin e tij në rajon dhe në Evropë. Besimi fetar është një çështje me të cilën përballen shumica e të rindjeve në jetën e tyre të përditshme, në hapësirën publike, në shkollë, universitet apo në punë. Studimi i raportit të të rindjeve me besimin fetar në Shqipëri nuk është hulumtuar më parë në mënyrë të thelluar. Studimi i perceptimit të të rindjeve shqiptarë mbi besimin fetar dhe sidomos i modelit të harmonisë ndërfetare në Shqipëri, shërben për të identifikuar mënyrat më të mira të kultivimit të kësaj vlore kulturore, në mënyrë që besimi fetar të mos jetë burim konfrontimi, por të shihet ekskluzivisht nëpërmjet lenteve të mirëkuptimit, tolerancës dhe pranimit të besimeve të tjera.

Hulumtimi fokusohet fillimisht tek dimensioni historik dhe rëndësia e bashkëjetesës paqësore ndërfetare në Shqipëri përgjatë historisë, tek mënyra sesi ajo është sendërtuar dhe integruar si pjesë e identitetit kombëtar, përmes proceseve shekullore historike, si dhe tek sfidat me të cilat kjo vlerë historike përballet në epokën e sotme globale. Ai ofron gjithashtu një interpretim të kuadrit ligjor të organizimit të besimeve fetare në Shqipëri, në prizëm historik, për të vijuar me rëndësinë e të kuptuarit të impaktit që kjo vlerë ka sot ndër të rindjtë shqiptarë. Më tej, hulumtohen në thellësi rezultatet e sondazhit të realizuar me të rindjtë e shkollave dhe universiteteve shqiptare, për të eksploruar fryshten e tolerancës dhe harmonisë fetare mes të rindjeve. Analiza përshkon tre dimensione kryesore: i) lirinë e besimit mes të rindjeve në familje dhe komunitet; ii) situatën e edukimit mbi liritë fetare në institucionet arsimore; si dhe iii) perceptimin e kësaj kategorie të shoqërisë shqiptare rrëth radikalizimit dhe ekstremizmit, duke identifikuar kështu një tërsi komponentësh që mund të shërbejnë për të luftuar përhapjen e këtyre fenomeneve mes të rindjeve në Shqipëri.

METODOLOGJIA E STUDIMIT DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Ky studim do të bazohet në një qasje të ndërthurur metodologjike, që kombinon analizën cilësore me atë sasiore, për të hulumtuar lirinë e besimit, harmoninë dhe bashkekzistencën paqësore midis komuniteteve fetare në Shqipëri, me fokus rolin që ky model mund të ketë tek të rinxjtë për të parandaluar fenomene të tilla si, përhapja e intolerancës fetare apo radikalizimi që çon në ekstremizëm. Si i tillë, ky është një studim eksplorues, që ndërthur shqyrtimin e burimeve parësore dhe dytësore për të kuptuar gjendjen e harmonisë dhe bashkekzistencës ndërfetare në shoqërinë shqiptare, e lirisë së besimit mes të rinxve, në familje dhe në komunitet, rëndësinë që ka për të rinxjtë edukimi mbi liritë themelore dhe ato të besimit fetar në sistemin arsimor shqiptar, si dhe shkallën e të kuptuarit që kanë ndërtuar të rinxjtë mbi ideologjitetë ekstremiste.


Studimi ndërmerr një shqyrtim të imtësishëm të literaturës ekzistuese rrëth evoluimit të besimit fetar në Shqipëri dhe modeleve historike të harmonisë dhe bashkekzistencës në shoqërinë shqiptare. Shqyrtimi i literaturës fokusohet kryesisht tek analiza e të dhënavë, raporteve, dokumenteve politike dhe strategjive. Pjesë e literaturës është gjithashtu konteksti ligjor dhe strategjik i Shqipërisë lidhur me lirinë e besimit fetar, sfidat rinore dhe fenomenet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu përdoren edhe një sërë instrumentesh matës e krahasimorë evropianë lidhur me faktorët që ndikojnë në ndërtimin e konceptit të tolerancës mes të rinxve në vendet e tjera të Ballkanit dhe në vendet e Bashkimit Evropian. Qëllimi i shqyrtimit të literaturës është të ofrojë një kontekst të quartë historik të modelit të bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri, evoluimin e këtij modeli sidomos në shekullin e XX-të dhe në epokën e sotme dhe të analizojë nga pikëpamja cilësore nivelin e tolerancës fetare dhe lirisë së besimit midis të rinxve. Shqyrtimi i literaturës shërbën gjithashtu, i kombinuar me të dhënat që rezultojnë nga sondazhi kombëtar dhe intervistat e thelluara (të gjysëm-strukturuara) me aktorë kyçë, për të ndërtuar një model embrional indikatorësh të harmonisë ndërfetare mes të rinxve shqiptarë sot.

Për qëllimet e këtij studimi është zhvilluar një anketë kombëtare që targeton të rinxjtë e grupmoshës 15-35 vjeç.¹ Anketa është zhvilluar në shkallë kombëtare, me pjesëmarrje të hapur. Përzgjedhja e kampionit ka qenë e targetuar dhe orientuar tek popullata e nxënësve, studentëve dhe të rinxve në shkollat dhe universitetet e qyteteve e targetuara nga projekti. Për të synuar një përfaqësim sa më të plotë të kampionit, pyetësori është plotësuar paralelisht edhe në formatin *online*, përmes faqes së internetit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (i shpërndarë edhe nëpërmjet mediave sociale).

Kampioni përbëhet në total nga 1,114 të rinx intervistuar, 32% e të cilëve i përkasin grupmoshës 15-17 vjeç, 60% i përkasin grupmoshës 18-25 vjeç, dhe 7% grupmoshës 26-35 vjeç (*Grafiku 1*). Rreth 58% e të rinxve të intervistuar janë studentë, 35% nxënës, ndërsa pjesa tjeter nuk është në sistemin arsimor (*Grafiku 2*).


¹ Bazuar në përdorimin zyrtar të këtij instrumenti matës të grupmoshave nga Censusi Kombëtar i Popullsisë (2011). www.instat.gov.al/al/temat/censuset/censusi-i-popullsis%C3%AB-dhebanesave/#tab2 (parë për here të fundit më 17/05/2019)

1. Cilës grupmoshe i përkisni



Grafiku 1: Përbërja e kampionit.


2. Aktualisht jeni ... :



Grafiku 2: Shpërndarja "student/nxënës".

Përbërja gjinore e kampionit është 67% femra dhe 33% meshkuj (Grafiku 3).

3. Gjinia juaj:



Grafiku 3: Përbërja gjinore.

Pyetësori është strukturuar në katër pjesë: i) së pari, një informacion i përgjithshëm rreth të anketuarve; ii) së dyti, pyetësori synon të grumbullojë informacion më të strukturuar rreth lirisë së besimit mes të rinjve në familje dhe komunitet (lidhur me përkatësinë/bindjet fetare), shpeshtësinë e praktikimit të besimit, kontaktet e të rinjve me besimet e tjera, vendin që zë feja mes të rinjve, etj.; iii) së treti, pyetësori synon të eksplorojë qasjen e të rinjve lidhur me edukimin dhe liritë fetare në shkolla, për të kuptuar nivelin e njojurive të të rinjve lidhur me këto tematika, intensitetin e diskutimeve të këtyre çështjeve në shkolla dhe institucionale arsimore, si dhe burimet e informimit të të rinjve mbi çështjet fetare; iv) së katërti, pyetësori i qaset problematikës së fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit mes të rinjve, perceptimit të tyre rreth këtij fenomeni, qasjes së të rinjve ndaj simboleve/simbolikave fetare, apo edhe perceptimit të të rinjve lidhur me shkallën e sfidës nga ekstremizmi (jo vetëm ai fetar).

Kuadri metodologjik i këtij studimi plotësohet me **intervistat e thelluara** (të gjysëm-strukturuar) me një spektër të gjerë aktorësh, përfshirë përfaqësues të institucioneve (si Komiteti Shtetëror i Kulteve), përfaqësues të komuniteteve fetare (si Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, përfaqësues nga komuniteti katolik), të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, të Qendrës së Bashkëpunimit Ndërfetar, të Drejtorisë Arsimore Rajonale (Tiranë), të shkollave të mesme ("Isa Boletini" dhe "Ibrahim Rrugova", Kamëz), studiues dhe analistë të çështjeve fetare dhe specialistë të arsimit parauniversitar dhe universitar.² Në total u zhvilluan 10 intervista të tilla, që synojnë eksplorimin më në thellësi të tematikave si: i) shpeshtësia dhe llojet e aktiviteteve të zhvilluara brenda institucioneve arsimore (me nxënësit dhe të rinjtë/studentët) mbi lirinë e besimit, si dhe përfshirja e komuniteteve të prindërve në to; ii) prania/mungesa e shfaqjeve të paragjykimeve fetare brenda institucioneve arsimore; iii) nevoja për informimin e nxënësve rreth besimeve fetare; iv) informimi i këtyre grupave të aktorëve mbi Strategjinë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe rolet e institucioneve të sipërpërmendura në kuadrin e saj; si dhe v) nivelin e kualifikimit të stafeve (akademike, nepunësve civilë, mësuesve apo edhe politikëbërësve) lidhur me kuptimin e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në Shqipëri. Përzgjedhja dhe identifikimi i të intervistuarve dhe aktorëve kyçë u bë pas të dhënave paraprake të grumbulluara nga shqyrtimi i literaturës dhe kuadrit strategjik dhe ligjor dhe pas identifikimit të institucioneve më të rëndësishme përgjegjëse.

Në këtë pikë është e rëndësishme të nxirren në pah edhe disa **kufizime metodologjike** të këtij studimi, si vështirësitet për të shpérndarë në mënyrë më përfaqësuese kampionin e të anketuarve, bazuar në një metodologji rigorozisht statistikore. Megjithatë, përzgjedhja e kampionit është bërë me vetëdije midis të rinjve të bashkive të targetuara nga ky projekt si dhe nga disa universitete (në Elbasan, Durrës dhe Tiranë), për të siguruar një informacion sa më të vlefshëm për përpunimin e të dhënave. Një vështirësi tjeter statistikore lidhet me faktin se Censusi i fundit kombëtar i popullsisë është realizuar në vitin 2011, ndërsa dekadëën e fundit dinamikat demografike kanë pësuar ndryshime të konsiderueshme, çka e bën më të vështirë përzgjedhjen e një kampioni statistikisht përfaqësues.

² Një listë e plotë e të intervistuarve për këtë studim gjendet në Aneksin 2 në fund të tij.

I. KONTEKSTI HISTORIK I HARMONISË DHE BASHKEKZISTENCËS FETARE NË SHQIPËRI

Harmonia dhe bashkekzistenca ndërfetare, e kuptuar si mirëkuptim dhe bashkëjetesë paqësore, mund të konsiderohet një prej tre vlerave më të spikatura kulturore të shoqërisë shqiptare, krahas mikpritjes dhe besës, jo vetëm nga pikëpamja historike, por edhe në epokën e sotme. Në epokën e sotme të sfidave të shumta globale, mes të cilave spikat keqpërdorimi dhe keqinterpretimi i fesë për qëllime të tjera, bashkëjetesa paqësore midis feve në shoqërinë shqiptare mund të shërbejë si model i veçantë që mund të promovohet si shenjë dalluese e një shoqërie historikisht tolerante.

Modeli i bashkëjetesës paqësore dhe harmonisë ndërfetare në Shqipëri ka shërbyer si shembull dhe vlerë identifikuese e shoqërisë shqiptare dhe si pjesë e identitetit kulturor e social shqiptar, duke tërhequr vëmendjen e autoriteteve fetare të vendeve të ndryshme në botë. Kështu, në vitin 2014, Papa Francesku gjatë vizitës së tij në Tiranë deklaroi se: “*ekziston një karakteristikë shumë e bukur e Shqipërisë, e cila më mbush me gëzim të madh: i referohem bashkekzistencës paqësore dhe bashkëpunimit që ekziston këtu midis besimeve të ndryshme fetare*”. Në vitin 2017, Raportuesi i Posacëm i OKB-së për lirinë e besimit fetar, Ahmed Shaheed vizitoi Shqipërinë dhe, ndër të tjera, deklaronte se: “*liria e fesë ose bindjeve fetare është realitet në Shqipëri*”, dhe se “*nga eksperiencia shqiptare ka shumëcka për të mësuar për respektimin e lirisë së mendimit, fesë dhe harmonisë ndërfetare*”. Megjithatë ai do të paralajmëronte se: “[...] një bashkëjetesë e tillë unike dhe respekt reciprok midis grupeve të ndryshme fetare nuk duhet konsideruar e mirëqenë dhe e paprapësueshme [...] pasi situata mund të ndryshojë më shpejt se çmund ta imagjinojnë shumë njerëz.”³

Bashkëjetesa paqësore midis tre prej komuniteteve më të mëdha shqiptare – mysliman, katolik dhe ortodoks, bashkë me komunitetet më të vogla fetare – ka përbërë një tipar identitar të kombit shqiptar, një veçori dalluese në historinë e Ballkanit dhe të Evropës. Historia e dy dekadave të fundit në marrëdhëni ndërkombëtare, sidomos në Evropë dhe në rajonin e Ballkanit, ka treguar se ekuilibrat fetarë janë shpesh të vështirë për t'u ruajtur, lehtësish të manipulueshme dhe pasojat e tyre të rënda. Prishja e këtyre ekuilibrave mbart potencialin që mund t'i japë jetë lëvizjeve ekstremiste në të gjitha kahet e spektrit politik, të krijojë pakënaqësi dhe përplasje të thella brenda shoqërive perëndimore, si dhe të formojë stereotipa sociale të vështira për t'u eliminuar, duke penguar zhvillimin social dhe duke izoluar grupe të mëdha shoqërore.

Bashkëjetesa paqësore mes komuniteteve fetare në Shqipëri, duke plotësuar njëri-tjetrin, kanë shërbyer si një model unik jo vetëm gjatë shekujve të mëparshëm, por gjithnjë e më shumë në epokën e sotme të sfidave globale. Kjo bashkëjetesë dëshmohet sidomos nga ekzistencë e objekteve të kultit, si xhamitë, kishat e manastiret, të cilat ndërthuren përgjatë shekujve, si provë se feja ka luajtur gjithnjë rol paqtues në identitetin kombëtar.

Megjithatë, kjo traditë bashkëjetese paqësore ndërfetare midis shqiptarëve, si një vlerë që vjen në modernitet përmes një procesi formimi shekullor, nuk mund të konsiderohet e përjetshme dhe e pandryshueshme, prandaj ajo duhet ruajtur dhe kultivuar në mentalitetin e njerëzve.

3 Tirana Times (2017). *UN praises Albania on freedom of religion, urges solutions for property issues.* <http://www.tiranatimes.com/?p=132499> (parë për here të fundit më 9/10/2018).

Ky element i identitetit shqiptar është trajtuar nga një numër i madh studiuesish, jo vetëm gjatë shekullit të XX-të, por edhe më parë, të cilët kanë përmendur gjerësisht shkëputjen e ndjenjës së përkatësisë kombëtare nga identiteti fetar. Kështu për shembull, që në fillimet e shekullit të XIX-të, Lord Bajroni shkruante: "*I dua shqiptarët, nuk janë të gjithë myslimanë; disa nga fiset e tyre janë të krishtera. Feja nuk i bën të ndryshojnë zakonet e tyre.*"⁴ Një tjetër bashkëkohës i tij anglez, kleriku Hygens, shkruante: "*Muslimani shqiptar izolohet në fenë e tij. Shpesh ai martohet me një grua të krishterë, merr me vete në xhami djemtë, kurse vajzat i lë të shkojnë me t'ëmën në kishë dhe vetë shkon me radhë në të dy qendrat e kultit.*"⁵ Një tjetër e dhënë historike vjen nga Edith Durham, e cila në librin "Brengat e Ballkanit" e ka pasqyruar gjerësisht identitetin shqiptar, si të veçuar dhe përtej atij fetar.⁶

Prandaj mund të argumentohet se, në shtresëzimin identitar të shqiptarëve, ndjenja kombëtare ka qëndruar historikisht mbi dallimet sipas përkatësisë fetare. Vetëpërcaktimi etnik i është mbivendosur vetëpërcaktimit fetar, kjo edhe për arsyet e rrethanave gjeopolitike, të cilat historia i ka imponuar në mënyrë përcaktuese mbi Ballkanin dhe në veçanti Shqipërinë. Sipas studiuesit G. Kruja, "*Shqipëria ka qenë zona ku takoheshin dhe ndaheshin dy perandoritë më të mëdha të mesjetës: Roma dhe Bizanti. Ajo ishte vendi ku takohej dhe ndahej autoriteti i dy kishave: romane dhe bizantine. Dy perandoritë dhe dy kishat, megjithëse rivale dhe kundërshtare të forta të njëra-tjetrës, tek shqiptarët asnjëherë nuk u bënë shkak konflikti.*"⁷ Prandaj nisur nga këndvështrimi historik dhe gjeopolitik, harmonia ndërfetare mund të konsiderohet një tipar etnologjik i shqiptarëve, i forcuar nga pozita gjeopolitike në të cilën është ndodhur shpesh Shqipëria, në kryqëzimin e dy botëve: lindjes dhe perëndimit.

Ky proces i gjatë historik, ka formësuar idenë se dallimet, si ato fetare, kulturore, krahinore, etj, nuk përbëjnë rrezik, por pasuri, e cila është kultivuar, njësoj si komponentët e tjerë të identitetit. Pluralizmi paqësor fetar ka shërbyer si element bashkues midis njerëzve, familjeve dhe grupeve të ndryshme në shoqëri. Komunitetet fetare mbeten besnikë e frymëzimeve të tyre fillestare të së mirës dhe paqes, si dhe me përkushtim të madh luajnë rol aktiv në kapërcimin e problemeve sociale, shoqërizimin e të rinjve, forcimin e rolit të familjes, kulturës dhe identitetit kombëtar. Me kontributin e tyre të veçantë Shqipëria përfaqëson edhe një nga rastet e rralla të një vendi me besime të ndryshme fetare, ku të gjithë faktorët politikë të shoqërisë, përfshirë edhe komunitetet fetare, janë përkrahës të fuqishëm të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO.

Vlerat nuk janë të përjetshme, këto tipare të diversitetit fetar në Shqipëri duhen ruajtur e kultivuar në mentalitetin e qytetarëve dhe kulturën demokratike. Në të njëjtën mënyrë është e nevojshme të shndërrohet kultura e dialogut midis besimeve dhe komuniteteve të ndryshme fetare, në urë komunikimi, shkëmbimi dhe lidhje më të fortë midis njerëzve e vendeve.⁸

4 Faik Konica "Letër e Lord Bajronit nga Preveza, 13 Tetor, 1809", tek "Udhëtimi i Lord Bajronit në Shqipëri". *Albania, Viti 9, Nr. 8, 1905.* <http://www.gazetatema.net/2015/10/03/letra-byron-para-206-vjetesh-shqiptaret-nuk-i-japin-rendesi-fese/> (parë për here të fundit më 27/05/2019)

5 Berisha, Sh. (2005), "*Shqipëria dhe shqiptarët ne veprat e udhëtarëve të shekullit XIX*", Tiranë.

6 Durham, E. (1990) "Bengat e Ballkanit", Tiranë. Në një prej atyre që mund të konsiderohet ndër provat më të drejtpërdrejta të perceptimit të të huajve mbi bashkëjetësen fetare në Shqipëri, ajo përmend: "Kur kaloja në Rumeli pyeta popullin. Çfarë je ti? Katolik, u përgjigji njëri. Protestant, tjetri. Në Bullgari, çfarë je ti? Ortodoks. Duke hyrë në Shqipëri, pyeta, juve këtu çfarë jeni? - shqiptarë m'u përgjigji njëri troç. Më në fund thashë. Këtu u çlirona nga maniakët".

7 Kruja, G. (2017). "Një vështrim sociologjik mbi bashkëjetësen dhe mirëkuptimin ndërfetar tek shqiptarët", në: <http://www.nacionalalbania.al/2017/09/nje-veshtrim-sociologjik-mbi-bashkejetesen-dhe-mirekuptimin-nderfetar-te-shqiptaret/> (parë për herë të fundit më 20/05/2019)

8 Kruja, G. (2017), *po aty.*

Por a duhet konsideruar bashkëjetesa dhe harmonia ndërfetare në Shqipëri më shumë si tolerancë fetare apo indiferencë ndaj besimit fetar? Studiuesit shfaqen skeptikë lidhur përdorimin e konceptit të tolerancës në rastin shqiptar. Kjo për shkak se toleranca është një koncept analistik që përshkruan raportin midis një grupei të fortë dhe një grupei të dobët, duke i vendosur kësosoj ata në raporte fuqie mes njëri-tjetrit.⁹ Kjo gjë nuk vërehet në rastin e Shqipërisë, ku analiza e shembujve të shumtë historikë nxjerr në pah më shumë një bashkëjetesë paqësore dhe harmonike, sesa nevojën e një komuniteti fetar për të toleruar një komunitet tjetër.¹⁰ Për këto arsyen, përgjatë këtij studimi do të përdoren në mënyrë të ndërthurur konceptet e harmonisë, bashkekzistencës dhe bashkëjetesës paqësore midis komuniteteve fetare në Shqipëri.

Nga pikëpamja historike e zhvillimit të besimeve fetare në Shqipëri, mund të identifikohen tre periudha kryesore: i) nga dekadat fundit të shekullit të XIX-të, përgjatë dhe pas shpalljes së pavarsësisë; ii) gjatë periudhës së diktaturës komuniste; dhe iii) në thuajse tre dekadat që kanë pasuar vendosjen dhe fuqizimin e sistemit demokratik pas vitit 1990.

Gjatë periudhës së parë besimi fetar ka shërbyer si një mekanizëm shtesë për të kultivuar identitetin e ri shqiptar që po lindte. Ndërsa në epokën e dytë, besimi fetar është vendosur nën presionin e sistemit diktatorial, fillimisht duke e dobësuar dhe pastaj zhdukur plotësisht atë. Kjo u bë e mundur nëpërmjet prishjes së kishave dhe xhamive, për të vendosur prej vitit 1967, shtetin e parë dhe të vetëm ateist të botës. Dëmtimi dhe zhbërja e çdo indi të besimit fetar në Shqipëri gjatë periudhës komuniste pati pasoja të mëdha të cilat ndihen deri sot e kësaj dite. Kështu, përvèç prishjes së objekteve të kultit, u eliminua njëherazi edhe një brez i tërë udhëheqësish fetarë, çka në periudhën e tretë nëpër të cilën ka kaluar historia e besimeve fetare në Shqipëri (gjatë dhe pas viteve 1990-të), e gjeti vendin me mungesa të theksuara të teologëve të përgatitur, në gjendje të rindërtonin themelit e besimeve fetare.

Në Shqipëri, liria e fesë u rikthye pas rënies së regjimit komunist. Rikthimi i besimit fetar solli me vete dhe dyndjen e shumë rrymave të reja që kanë prodhuar përplasje jo vetëm doktrinore brenda vetë komuniteteve tradicionale fetare. Sipas të dhënave që gjenden në zyrën përkatëse të Komitetit Shtetëror për Kultet pranë Kryeministrisë, aktualisht ne vend janë regjistruar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre 241 organizata fetare (ku 100 prej tyre janë kisha baptiste që secila rezulton e regjistruar si organizatë më vete).¹¹ Kjo gjithashtu u pasqyrua dhe në nevojën për një brez të ri teologësh, të cilët filluan të studionin në qendrat fetare jashtë vendit, për t'u kthyer në fund të viteve 1990-të duke plotësuar gradualisht

9 Në lidhje me këtë qasje bien dakord jo vetëm ekspertët shqiptarë të intervistuar për qëllimet e këtij studimi, si Z. Fitim Zekthi, Z. Genti Kruja, Znj. Elona Mehmeti, por edhe ish-kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Z. Skënder Bruçaj.

10 Siç përmend edhe një prej hulumtuesve të bashkëjetesës fetare në Shqipëri, Kahraman Ulqini (1999), tek studimi i tij "Faktorë kulturorë e fetarë", [...] në vitet pesëdhjetë në Mat kishte shumë kisha të braktisura prej qindra vitesh, të cilat u lanë ashtu, e askush nuk prekte një gur. "Janë vakuf", thonin banorët [...]. Ulqini, K. (1999). *Faktorë kulturorë e fetarë*. Shkodër: 29.

Në një tjetër rast: "konsulli austro-hungarez në Durrës shkruante më 13 korrik 1881 se në atë qytet, në Kavajë e në Tiranë ishte doke e vjetër që edhe myslimanët të merrnin pjesë në varrimet e të krishterëve. [...]" "Ndërsa Faik Konica kujtonte shpeshherë se kur i vdiq e ëma, të krishterët u ranë kambanave në shenjë zie. [...]" Ulqini, K. Po aty, f. 32.

Ulqini sjell gjithashut disa shembuj të tjerë të bashkëjetesës paqësore mes feve në Shqipëri, ku që prej gjysmës së dytë të shekullit të XVI-të (1568), një udhëtar italian (Pagafeta) viziton vendbanime shqiptare dhe vëren se murgjt e krishterë jetonin të lirë në mesin e myslimanëve dhe në asnjë rast nuk pengoheshin as faltoret, as njerëzit. Në një tjetër rast, një udhëtar tjetër francez (Palerine) dëshmon gjatë vizitës në Malishevë thuajse në të njëjtën periudhë (1582) se kallogjërat gjithashtu pasuri të madhe liri dhe mbrojtje nga myslimanët. Ulqini, K. Po aty, f. 25.

11 Kruja G. (2008). *Shqiptarët përballet sfidave të mirëkuptimit ndërfetar*. Tiranë: Arbëria, f. 142.

nevojat e komuniteteve fetare. Por kthimi i tyre u shoqërua shpeshherë dhe me doktrina fetare që nuk përputheshin me ato tradicionale shqiptare, çka krijoi fërkimet e para brenda komuniteteve fetare.¹² Gjithashtu, tranzicioni i gjatë shqiptar nxori në pah vështirësitë e shtetit shqiptar për të mbështetur financiarisht komunitetet fetare, problematikë e cila vijon të mbetet shumë e mprehtë në ditët e sotme, duke rritur varësinë e komuniteteve fetare nga donacionet e huaja. Kjo lidhet gjithashtu me mungesën e një kuadri të plotë ligjor për financimin e komuniteteve fetare, pasi kuadri aktual ligjor nuk mjafton për mbulimin e nevojave financiare të komuniteteve fetare.¹³

Kuadri ligjor brenda të cilit është e organizuar jeta e komuniteteve fetare mund të ndahet gjithashtu në tre pjesë, duke ndjekur kategorizimin e sipërpërmendur. Kështu, deri në vitin 1939, legjislacioni përfshirë fenë bazohej kryesisht në statutet, të cilat ishin ligji themelor i Shtetit Shqiptar në atë kohë, si dhe në ligjet përfshirë komunitetet fetare. Gjatë kësaj periudhe një rol të rëndësishëm kanë patur reformat shtetërore përfshirësimin e legjislacionit përfshirë fenë në Shqipëri. Kështu, në vitin 1929 u miratua ligji 'Për formimin e komuniteteve fetare', i cili mbështetet në Statutin legal të komuniteteve fetare të miratuar që në vitin 1924. "Ligji dëshmone qartë një kombëtarizim të rreptë të institucioneve fetare në Shqipëri, si dhe një kontroll të dukshëm të institucioneve shtetërore mbi ato fetare"¹⁴. Ahmet Zogu u shfaq si mbret reformator dhe qeveria ndërmori një varg reformash. Kështu, jehonë të veçantë shkaktoi miratimi në Parlament i ligjit përfshirë komunitetet fetare, pasi kuadri aktual ligjor nuk mjafton përfshirë komunitetet fetare.¹⁵

Gjatë periudhës së diktaturës komuniste, deri në vitin 1967 kur u ndaluan institucionet fetare në Shqipëri, ishte në fuqi ligji i vitit 1951, mbi komunitetet fetare.

Pas rënies së sistemit monist, u rivendos liria e fesë në ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese të RSH-së" (1991) dhe filloj të ndërtohet një kuadri përfshirë komunitetet fetare, përmes një sërë ligjesh dhe marrëveshjesh rregullatore.¹⁶

Kushtetuta, si dokumenti themeltar i shtetit shqiptar, nuk njeh fenë zyrtare dhe shpall barazinë midis feve në Shqipëri. Në këtë drejtim, Kushtetuta është garanti më i lartë i lirive themelte, përfshirë edhe liritë fetare, duke përfshirë çdo formë diskriminimi përfshirë komunitetet fetare. Këto përcaktimes kushtetuese e bëjnë shtetin shqiptar modern laik dhe neutral në raport me besimet fetare (Neni 10 i Kushtetutës). Në nenin 24 (pika 1, 2 dhe 3) të Kushtetutës garantohen liria e fesë, shfaqja e bindjeve fetare individualisht ose kolektivisht, në publik ose privat, si dhe konfirmohet e drejta përfshirë komunitetet fetare.¹⁷

Pas viteve 1990-të shteti nuk ka qenë indiferent ndaj besimit fetar, duke mbrojtur jo vetëm pluralizmin politik e ideologjik, por edhe atë fetar. Prandaj juridikisht, rapporti i shtetit

12 Hide, E. (2016). *Emerging Security Issues: Countering Violent Extremism*. Studim strategjik, Qendra e Ekselencës, Tiranë: Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë.

13 Intervistë me Z. Genti Kruja, Drejtor Ekzekutiv i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, 15 Maj 2019.

14 Shih: Aurela Anastasi, *Historia e të drejtës Kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë, 2007, fq. 196

15 Shih më gjerë po aty, fq. 196-206.

16 Të tillë si: Ligji 8902 përfshirë Marrëveshjen e Republikës së Shqipërisë me Selinë e Shenjtë; Ligji 9365, mbi procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë të Kishës Katolike; Ligji 10056, Marrëveshja me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë; Ligji 10057, Marrëveshja me Kishën Ortodokse; Ligji 10058, Marrëveshja me Kryegjyshatën Botërore të Bektashinjve; Ligji 10140, përfshirë komunitetet fetare; si dhe Ligji 10349, Marrëveshja me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë. Më tej lidhur me rregullimin e kuadrit ligjor të komuniteteve fetare në Republikën e Shqipërisë, shih: <http://kshk.gov.al/legjislacioni-per-fene-ne-periudhen-1939-1945/> (parë përfshirë herë të fundit më 15/06/2019).

17 Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 24, pikat 1, 2 dhe 3.

shqiptar me besimet fetare mund të konsiderohet i një “*neutraliteti aktiv*” – duke siguruar në mënyrë të vazhdueshme barazinë. Siç argumenton Karl Popper, “*liria absolute dhe toleranca pa kufi, rrezikojnë të çojnë drejt mohimit të vetë lirisë dhe tolerancës*”.¹⁸

Rikthimi i lirisë fetare në Shqipëri gjatë e pas viteve 1990-të është shoqëruar me debate të mëdha teorike për të kuptuar më mirë rrënjet e bashkëpunimit dhe procesin e bashkëjetesës midis komuniteteve fetare, edhe duke e krahasuar atë me vendet e tjera që kaluan procesin e tranzicionit në Ballkan dhe Evropë. Ndërkohë, ky debat është ndikuar padyshim edhe nga sfidat që pasuan sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001. Këto sfida lidhen pikësëpari me keqpërdorimin e fesë me qëllim përligjen e akteve të dhunës, si dhe retorikën e përplasjes së qytetërimeve, të mbështetur në teorinë e Samuel Huntington (1993) si model i konflikteve të së ardhmes.¹⁹

Ky debat është gjallëruar sidomos gjatë dekadës së fundit (pas vitit 2012 dhe konflikteve në Siri e Irak), për shkak edhe të përfshirjes së një numri shtetasish nga Ballkani Perëndimor në këto konflikte dhe debatit publik që pasoi këtë proces.²⁰ Megjithatë, shoqëria shqiptare ofron në këtë aspekt shembullin më interesant jo vetëm në të gjithë rajonin, por edhe në Evropë e më gjerë, atë të harmonisë ndërfetare, si një model organizimi shoqërор që mund të funksionojë si instrument i parandalimit të përcarjeve sociale mbi baza fetare. Siç ka argumentuar dikur Faik Konica: “[...] *Dihet që shqiptarët janë tolerantë për besimet e tjera dhe ndoshta ky është i vetmi vend në Evropë ku nuk ka pasur luftëra fetare. [...]*”²¹

Radikalizmi dhe ekstremizmi. Ekzistojnë debate të gjera mbi kuptimin e termave “radikalizëm” dhe “ekstremizëm i dhunshëm”, si në nivel teorik ashtu dhe politikëbërës, kombëtar dhe ndërkombëtar. Megjithatë, për qëllimet e këtij studimi, do të përdoret qasja e BE-së ndaj këtyre termave. Prandaj, me radikalizëm do të kuptojmë përqafimin e një ideologjive radikale, ose një qasje radikale ndaj tematikave socio-politike dhe fetare që mund të çojë drejt ekstremizmit, ndërsa me ekstremizëm të dhunshëm do të kuptohet përdorimi i dhunës për të promovuar bindjet ideologjike dhe/ose fetare.²² Që prej vitit 2012, Shqipëria është përballur me një sfidë të re sigurie, radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Të dhënët e fundit, të vitit 2018, tregojnë se 148 qytetarë shqiptarë kanë udhëtuar drejt Sirisë (kryesisht gjatë periudhës 2012-2016), për t'u angazhuar atje me grupet e armatosura terroriste, përfshirë 31 fëmijë dhe 13 gra.²³ Nëse nuk adresohet që në etapat e para, radikalizimi që çon në ekstremizëm të dhunshëm bart potencialin të dëmtojë rëndë modelin e harmonisë ndërfetare dhe të bashkekzistencës paqësore mes feve në Shqipëri.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka zhvilluar një tërësi mekanizmash, të brendshëm dhe të jashtëm, për të trajtuar rastet e ekstremizmit të dhunshëm. Vendi ka ndërtuar një kuadër të brendshëm ligjor, institucional dhe strategjik, për t'u përballur me ekstremizmin e dhunshëm dhe për të trajtuar individët e përfshirë në zona konflikti jashtë vendit. Gjithashtu janë shtuar disa parashikime ligjore në Kodin Penal mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e

18 Popper, K. & Gombrich, E. H. (2013). *The Open Society and Its Enemies*. Princeton and Oxford: Princeton University Press.

19 Huntington, S. (1993, Pranverë). *Clash of Civilizations?* Foreign Affairs.

20 Azinovic, V. (2018, Qershori). *Understanding Violent Extremism in the Western Balkans*. Regional Report. Extremism Research Forum.

21 Konica, F. (1993). *Vepra I*. Tirana: Shtëpia Botuese Naim Frashëri, f. 431.

22 https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/policies/crisis-and-terrorism/radicalisation_en (parë për herë të fundit më 06/10/2019)

23 Hide, E. & Llubani, M. (2018, July). *The Role of Albania's Civil Society in Countering Violent Extremism*. Friedrich Ebert Stiftung, Tirana, Albania.

dhunshëm. Që prej nëntorit të vitit 2015, Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e Veprimit (Nr. 930, dt. 18/11/2015). Sa u takon mekanizmave dhe instrumenteve të jashtëm, së pari, si shtet-anëtar i NATO-s, Shqipëria është përfshirë prej më shumë se një dekade në koalicionet ndërkombëtare kundër dhunës ekstremiste.²⁴ Shqipëria ka qenë shumë aktive diplomatikisht në forume dhe organizata ndërkombëtare, duke u bërë palë e konventave, traktateve apo iniciativave të tilla në kuadrin e OKB-së²⁵, OSBE-së, Këshillit të Evropës²⁶, si dhe përkundrejt detyrimeve ndaj Bashkimit Evropian²⁷, si vend kandidat për t'u anëtarësuar në organizatë. Ndërkohë në kuadrin e luftës kundër ekstremizmit, në Shqipëri janë ndaluar edhe një numër individësh, të ngarkuar me akuza që lidhen me terrorizmin, financime të terrorizmit, pjesëmarrje në luftime jashtë territorit të vendit, etj. Këta individë aktualisht janë dënuar dhe janë duke vuajtur dënimet pas disa proceseve gjyqësore.²⁸

Të rinjtë. Së fundi, të rinjtë përbëjnë një ndër variablat më të rëndësishme të modelit të harmonisë ndërfetare të shoqërisë shqiptare, pasi ata mund të kontribuojnë jo vetëm në qëndrueshmërinë e këtij modeli në të ardhmen, por edhe për promovimin e tij në rajon dhe në Evropë. Besimi fetar është një çështje me të cilën përballen shumica e të rinjve në jetën e tyre të përditshme, në hapësirën publike, në shkollë, universitet apo në punë. Studimi i raportit të të rinjve me besimin fetar në Shqipëri nuk është hulumtuar më parë në mënyrë të thelluar. Studimi i perceptimit të të rinjve shqiptarë mbi besimin fetar dhe sidomos i modelit të harmonisë ndërfetare në Shqipëri, shërben për të identifikuar mënyrat më të mira të kultivimit të kësaj vlere kulturore, në mënyrë që besimi fetar të mos jetë burim konfrontimi, por të shihet ekskluzivisht nëpërmjet lenteve të mirëkuptimit, tolerancës dhe pranimit të besimeve të tjera. Kështu ai mund të shërbejë si model për t'u përballur edhe me sfidën e përhapjes së ekstremizmit të dhunshëm midis të rinjve.

Sipas Censusit të Popullsisë (2011), të rinjtë e moshës 15-34 vjeç përbënin 31.51% të popullsisë së përgjithshme të vendit.²⁹ Nga ana tjetër, të rinjtë përbëjnë gjithashtu një prej indeve më të ndjeshme të zhvillimit të vendit. Sipas të dhënave të vitit 2017, niveli kombëtar i papunësisë ishte në 13.9%. Edhe më i lartë ishte ky nivel mes të rinjve.³⁰ Një prej mekanizmave më të rëndësishëm të përdorur në Shqipëri për të fuqizuar rolin e të rinjve në komunitet dhe gjithëpërfshirjen komunitare në nivel lokal, është modeli i "Shkollave si Qendra Komunitare". Ky model, është lançuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve në vitin 2013 dhe synon t'u japë shkollave një rol të ri si qendra komunitare, me një axhendë gjithë-vjetore aktivitetesh, duke garantuar edhe pjesëmarrjen e një numri të madh aktorësh

24 Për këtë shih: <http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2013/224822.htm> (parë për herë të fundit më 12/04/2019).

25 Një listë e plotë e traktateve që ka nënshkruar Shqipëria në OKB në lidhje me luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar gjendet tek: https://treaties.un.org/Pages/DB.aspx?path=DB/studies/page2_en.xml (07/06/2019).

26 Në vitin 2007 Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit. Ajo është gjithashtu pjesë e Komisionit të Ekspertëve të Vlerësimit të Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, të Këshillit të Evropës.

27 Shqipëria është anëtare e Konventës Evropiane për Luftën kundër Terrorizmit, të Këshillit të Evropës (2005).

28 Hide, E. (2016). *Emerging Security Issues: Countering Violent Extremism*. Studim strategjik, Qendra e Ekselencës, Tiranë: Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë.

Gjithashtu, përmëshumë reth kësaj çështjeje: <https://sot.com.al/aktualitet/gjyqi-i-xhihadist%C3%ABve-prokuroria-imam%C3%AB-t%C3%AB-q%C3%ABn%C3%ABnrojn%C3%AB-n%C3%AB-burg-t%C3%AB-siguris%C3%AB-s%C3%AB-lart%C3%AB-t%C3%AB> (parë për here të fundit më 04 Gusht 2019).

29 Shih të dhënat për Censusin 2011 Tabela 1.1.1, në: www.instat.gov.al/al/temat/censuset/censusi-i-popullsis%C3%AB-dhebanesave/#tab2 (parë për herë të fundit më 17/05/2019).

30 Shih të dhënat e disponueshme nga "Pyetësori për Forcat e Punës, tremujori i fundit 2017", INSTAT, ff. 3-4. <http://www.instat.gov.al/media/2539/anketa-tremujore-e-forcave-t%C3%AB-pun%C3%ABs-t2-2017.pdf> (parë për here të fundit më 17/05/2019)

lokalë, përfshirë shoqërinë civile dhe komunitetet fetare, duke promovuar kësosoj edhe harmoninë e bashkekzistencën fetare.³¹ Një tjetër instrument i rëndësishëm i përfshirjes së të rinjve në jetën socio-kulturore është Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (2015-2020).³²

Në këtë drejtim ka rëndësi kyçe arsimimi mbi të drejtat e njeriut, sidomos në grupet e marxhinalizuara të të rinjve, në zonat rurale dhe të thella, të cilat mund t'iu kundërvihen ideologjive ekstremiste. Po ashtu rritja e kapaciteteve të të rinjve në disa fusha kyçe si të menduarit kritik, dialogu dhe zgjidhja paqësore e konflikteve, janë thelbësore në forcimin e modelit të bashkekzistencës mes të rinjve dhe respektimit të të gjitha të drejtave, përfshirë edhe ato të lirisë së besimit. Edukimi i të rinjve në këto çështje është thelbësor për zhvillimin dhe promovimin e diskurseve të përbashkëta të tolerancës dhe mirëkuptimit, kundër diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes, përfshirë edhe atë fetare. Siç argumenton Sinani (2017), "*edukimi fetar mund të kuptohet në kontekstin e edukimit qytetar, por edukimi fetar nuk është i njëjtë me edukimin qytetar. Për raportin mes tyre, edhe në nivelin europian në dy gjëra bihet dakord; edukimi fetar duhet parë si plotësues i edukimit qytetar, që ka potencialin të inkorporojë idetë globale dhe europiane të qytetarisë dhe të ndihmojë në debatin në shkollë rreth çështjeve, që lidhen më shoqërinë pluraliste. Edukimi fetar, në formën e edukimit ndërfetar, mund të kontribuojë në mirëkuptimin ndërkulturor, si dhe në tolerancën dhe harmoninë sociale.*"³³

Në këtë kuptim, modeli i bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve, duhet kultivuar edhe midis të rinjve, në të gjitha nivelet arsimore, si një produkt historik dhe si një vlerë sociale dhe kulturore.

31 Shih, <http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/shkollat-si-qendra-komunitare&page=23> (parë për here të fundit më 24/04/2019)

32 http://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/plani-kombetar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020_Shqip.pdf (parë për herë të fundit më 25/04/2019)

33 Sinani, Gj. (2017). *Feja dhe Edukimi*. Tiranë: Friedrich Ebert Stiftung, f. 3.

II. LIRIA E BESIMIT DHE QASJA E TË RINJVE NË FAMILJE DHE KOMUNITET.

Liria e besimit dhe raporti që të rinjtë kanë me familjen dhe komunitetin lidhur me besimin e tyre përbën një ndër komponentët më të rëndësishëm të këtij studimi. Për të kuptuar këto raporte social-kulturore, janë shfrytëzuar instrumente matëse nëpërmjet anketimit, si dhe janë krahasuar ato me të dhënrat e përgjithshme të popullsisë (bazuar në Censusin e popullsisë 2011), me periudha të mëparshme si dhe me vende të tjera. Këto instrumente matëse përfshijnë komponentë sa cilësorë (vetëdeklarimin) aq dhe sasiorë (kategorizimin) të besimit fetar midis të rinjve.

Instrumentet metodologjikë përfshijnë: vetëdeklarimin e besimit fetar; shpeshtësinë e praktikimit të fesë; interesimin e të rinjve për praktikimin e besimit të tyre fetar, kureshtjen apo interesin për t'u njojur me besimet e tjera fetare (sidomos nëpërmjet vizitave të objekteve të kultit); perceptimin e të rinjve për garantimin e lirisë së besimit në Shqipëri; rëndësinë e fesë në familje dhe komunitet; trajtimin e barabartë fetar në shkolla; ndikimin e të rinjve nga komuniteti; shkallën e diskutimeve për liritë dhe të drejtat e besimit në shkolla, komunitet, etj; perceptimi i të rinjve mbi martesat mes individëve që u përkasin besimeve të ndryshme fetare; si dhe sfidat më në përgjithësi të të rinjve në komunitetet ku ata jetojnë.


Përkatësia Fetare. Në sondazhin e zhvilluar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, siç mund të vërehet nga *Grafiku 4* më poshtë, 55% e të rinjve të anketuar për këtë studim i përkasin besimit Islam (përfshirë edhe atë Bektashi), ndjekur nga 14% të besimit katolik dhe 12% të besimit ortodoks. Vlen për t'u shënuar se një përqindje e konsiderueshme, 15% e të rinjve zgjedhin të thonë se nuk i përkasin asnjë besimi. Duke bërë një vështrim të krahasuar të rezultateve të këtij sondazhi me të dhënrat e Censusit të vitit 2011 vërejmë si vijon: këto rezultate reflektojnë në masë të konsiderueshme të dhënrat e Censusit të vitit 2011, sipas të cilit 58.79% e popullsisë u vetdekluar se i përkasin besimit Islam, 10% atij katolik dhe 6.75% atij ortodoks.³⁴ Pothuajse 20% e popullsisë gjatë Censusit të fundit ose janë deklaruar ateistë ose kanë refuzuar të përgjigjen. Kjo shifër e ngjashme edhe me të dhënrat e këtij sondazhi, gjë që tregon një tendencë edhe të të rinjve, për t'u identifikuar me prirjet e përgjithshme të popullsisë shqiptare.

Nëse i krahasojmë këto të dhëna me përvojat në vende të tjera, rezulton se ekzistojnë disa ngjashmëri. Sipas një studimi të vitit 2018 të rinjtë nëpër botë janë më pak besimtarë krahasuar me disa dekada më parë, me një ndryshim jo të vogël. Megjithëse një pjesë e mirë e të rinjve ende identifikohen me një besim fetar, ka një prirje në rritje të atyre që deklarojnë se nuk i përkasin asnjë besimi fetar. Sipas të dhënave të studimit, në 22 nga 35 vende në Evropë ka një hendek ndërmjet gjeneratave të ndryshme, ku të rinjtë janë më pak të prirur të thonë se i përkasin një besimi të caktuar.³⁵

34 INSTAT. 2011. Censusi i popullsisë dhe banesave. f. 71. http://www.instat.gov.al/media/3058/main_results_population_and_housing_census_2011.pdf (parë për herë të fundit më 14/05/2019)

35 Bullivant, S. (2018). *Europe's Young Adults and Religion. Findings from the European Social Survey (2014-2016)*. UK: Benedict XVI Center for Religion and Society.


4. A i përkisni një besimi të caktuar fetar?



Grafiku 4: Përkatësia fetare.

Ushtrimi i besimit fetar. Identifikimi me një besim të caktuar fetar nuk reflekton domosdoshmërisht angazhimin që ka një person kundrejt atij besimi fetar. Për këtë arsyе të anketuarit u pyetën më tej për shpeshtësinë e praktikimit të besimit të tyre fetar. Shumica dërrmuese, 70% në total, ose nuk e praktikojnë fare ose e praktikojnë vetëm në rastin e ditëve të shënuara fetare. Një pjesë jo e vogël, 14%, e praktikon çdo ditë besimin fetar. Ndërsa pjesa tjetër, 7% dhe 9%, e praktikojnë përkatësisht një herë në muaj dhe një herë në javë (Grafiku 5 më poshtë). Megjithëse nuk kemi të dhëna krahasuese në kohë për të vënë në dukje ndryshime të mundshme në prirjen për të praktikuar më pak ose më tepër besimin fetar, duhet theksuar përqindja e lartë e të rinjve që nuk e praktikojnë fare besimin e tyre fetar, edhe pse në pyetjen e mësipërme ata identifikohen me një fe të caktuar. Më tej të dhënrat e mbledhura nga Pew Research Center tregojnë se vetëm për 15% të të intervistuarve feja është ndër faktorët më të rëndësishëm në jetën e tyre, një shifër mjaft e ulët krahasuar me vende të tjera me popullsi myslimanë.³⁶

5. Sa shpesh e praktikoni besimin tuaj fetar?




Grafiku 5: Ushtrimi i besimit fetar.

36 Pew Research Center. 2018. Religion and Public Life. Online: https://www.pewforum.org/2018/06/13/how-religious-commitment-varies-by-country-among-people-of-all-ages/pf-06-13-18_religiouscommitment-03-07/

Ekzistojnë një sërë shpjegimesh dhe teorish të ndryshme që përpiken të shpjegojnë këtë hendek ndërmjet gjeneratave të ndryshme. Një prej këtyre shpjegimeve fokusohet tek zhvillimi ekonomik. Studimet e fundit kanë identifikuar një raport direkt midis rritjes së mirëqenies ekonomike dhe zhvillimit ekonomik e social, dhe mungesës së vëmendjes së të rinjve tek feja. Kjo lidhet gjithashtu drejtpërdrejt edhe me rritjen e nivelit arsimor, që disa studiues e lidhin me reduktimin e identitetit fetar dhe praktikimin e vetë fesë. Një tjetër shpjegim fokusohet në një aspekt më praktik jetësor. Sipas këtij shpjegimi diferençat në përkushtimin ndaj fesë mund të shpjegohen me ndryshime që përjetojnë njerëzit përgjatë jetës. Pra, edhe ata të rritur që kanë qenë më pak besimtarë në rini, mund të ndodhë të afrohen më tepër me fenë.³⁷

Frekuentimi i objekteve të kultit për kryerjen e riteve fetare. Për të kuptuar më tej masën në të cilën të rinjtë e anketuar e praktikojnë fenë e deklaruar, ata u pyetën gjithashtu nëse dhe sa shpesh i vizitojnë objektet e kultit të besimit të tyre fetar. Kështu, gati gjysma deklaron se i vizitojnë këto objekte vetëm në rastet e ditëve të shënuara fetare, ndërkohë që një masë e konsiderueshme (rreth 25%) e të rinjve nuk i vizitojnë asnjëherë këto objekte kulti. **Në tërësi, pothuajse 30% i frekuentojnë këto objekte rregullisht, çdo ditë, një herë në javë, ose një herë në muaj** (Grafiku 6).

6. A keni vizituar ndonjëherë objektet e kultit të besimeve të tjera?




Grafiku 6: Frekuentimi i objekteve të kultit për kryerjen e riteve fetare.

Kontakti me besimet e tjera fetare dhe praktikimi i fesë. Një pjesë e mirë e studimeve mbi dialogun dhe harmoninë ndërfetare në shoqëri multikulturore fokusohen tek njojha e feve të tjera, tejkalimi i paragjykimeve dhe gatishmëria për të kuptuar dhe vendosur veten në vendin e një personi me besim të ndryshëm.³⁸ Për të kuptuar interesin e kureshtjen e të rinjve për besimet e tjera, si dhe për të kuptuar sa të hapur janë ata ndaj besimeve të tjera fetare, të rinjtë u pyetën për lidhjet e tyre me objektet e kultit të besimeve të tjera fetare, të cilave nuk u përkasin. Një në 5 të rinj të anketuar nuk kanë vizituar asnjëherë një objekt kulti të një feje tjetër. Shumica megjithatë, e kanë vizituar të paktën një herë një objekt kulti të një feje tjetër. Ndërkohë 1 në 4 i vizitojnë shpesh objektet e kultit të një feje tjetër (Grafiku 7). Kjo tregon se të rinjtë shqiptarë janë relativisht të hapur në raport me besimet e tjera, se janë të interesuar për të kuptuar më shumë përfetë e tjera dhe se nuk shfaqin paragjykime.

37 Pew Research Center. 2018. *The age gap in religion around the world*: <https://www.pewforum.org/2018/06/13/why-do-levels-of-religious-observance-vary-by-age-and-country/>

38 Walt, V. D. (2014). *Measuring Religious Tolerance in Education*. South Africa: North-West University.

7. A keni vizituar ndonjëherë objektet e kultit të besimeve të tjera?



Grafiku 7: Kontakti me besimet e tjera fetare dhe praktikimi i fesë.


Garantimi i lirisë së besimit fetar në Shqipëri. Liria e besimit është një ndër të drejtat themelore dhe universale të njeriut shprehur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe një mori instrumentesh të tjera ndërkombëtare. Në kontekstin kombëtar është një ndër parimet bazike dhe udhëheqëse të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikuar në nenin 3, në nenin 24 të saj, i cili është neni klasik i lirisë së fesë, si dhe në nenin 10, i cili rregullon reportin midis fesë dhe shtetit mbi bazën e parimit të barazisë së bashkësive të ndryshme fetare përbërëse të shoqërisë shqiptare.

Ndër udhëzimet e Bashkimit Evropian për nxitjen e tolerancës fetare dhe respektimin e të drejtave themelore të individëve për të shprehur dhe ndjekur identitetin e tyre fetar "promovimi i tolerancës fetare, respekti për diversitetin dhe kuptimin e ndërsjelltë janë të një rëndësie parësore, me qëllim krijimin e një mjedisi mundësues për zotërimin e të gjithë lirisë nga të gjithë personat të besimit fetar."³⁹ Megjithëse këto parime janë të deklaruara dhe të pranishme në strukturën themelore institucionale dhe demokratike të një pjesë të mirë të shteteve, duke përfshirë Shqipërinë, aplikimi i tyre në realitet nuk është gjithnjë i suksesshëm. Për këtë arsyе promovimi i lirisë së besimit fetar kërkon ndërhyrje të institucioneve vendimmarrëse. Një ndër këto ndërhyrje të sanksionuara në udhëzimet e BE-së është edhe thirrja që u bëhet vendeve për të promovuar përmes sistemit arsimor respektin për diversitetin dhe kuptimin e ndërsjelltë duke inkurajuar njoħuri më të gjera mbi diversitetin e besimeve fetare brenda juridikzionit të tyre.

Për të kuptuar perspektivën e të rinjve të anketuar mbi ushtrimin e fesë në komunitetet e tyre, ata u pyetën për këndvështrimin e tyre sa i takon garantimit të lirisë së besimit fetar në Shqipëri. Kështu, shumica dërrmuese kanë pohuar se të gjithë qytetarët e Shqipërisë i kanë të garantuara liritë fetare. Ndërkohë pothuajse 1 në 4 deklaroi se këto liri janë pjesërisht të garantuara e më tej një përqindje jo e pakonsiderueshme, 8%, nuk e dinin ose refuzuan të përgjigjen nëse liria e fesë garantonhet në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët (Grafiku 8).

39 Council of the European Union, 2013. EU Guidelines on the promotion and protection of freedom of religion or belief. Online: <https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/137585.pdf> (parë për herë të fundit më 11/05/2019)


8. Në këndvështrimin tuaj, a garantoohen liritë fetare për të gjithë qytetarët e Shqipërisë?



Grafiku 8: Garantimi i lirisë së besimit fetar në Shqipëri


Vendi që zë besimi fetar në familje dhe individualisht Për të kuptuar më tej rolin që luan feja në jetën personale të të rinxve të anketuar, është interesante të vërehet se e njëjtë përqindje e konsideron fenë të ketë rol thjesht formal, pra që ndiqet kryesisht në festimin e ditëve të shënuara, dhe rol shumë të rëndësishëm, pra që e orienton personin në të gjitha vendimet jetësore (32% secila). Më tej 1 në 5 të anketuar deklarojnë se feja luan rol vetëm në momentet më të vështira në të cilat ata i drejtohen besimit fetar. Për këtë të fundit mund të ritheksojmë një prej teorive të përmendura më lart për ndryshimet ndërmjet gjeneratave në nivelin e praktikimit të fesë, i cili argumenton se ndërkohë që ndër të rinxjtë feja nuk luan një rol thelbësor, sa më shumë kalon koha aq më tepër ata i rikthehen praktikimit të fesë. Një prirje e ngashme vihet re edhe kur pyeten për rolin që zë feja në familjet e tyre. Shumica e të anketuarve, 44%, thonë se feja zë një rol formal, pra kryesisht lidhet me ditët e shënuara të cilat festohen në komunitet. Më tej për 33%, ose rreth 1 në tre të anketuar, pohojnë se feja zë një rol të rëndësishëm në familjet e tyre, pra se kanë qenë pjesë e diskutimeve mbi natyrën e fesë ose të besimit fetar në familje. Vetëm 9% prej tyre deklarojnë se feja ka rol tërësisht të parëndësishëm, pra nuk diskutohet pothuajse asnjëherë në ambientin familjar (Grafiku 9).

9. Çfarë roli ka feja për ju personalisht?



Grafiku 9: Vendi që zë besimi fetar në familje dhe individualisht.


9. Çfarë vendi zë feja në familjen tuaj?



Grafiku 9: Vendi që zë besimi fetar në familje dhe individualisht.

Roli i familjes në orientimin fetar të të rinjve Në literaturën që ka të bëjë me tolerancën dhe harmoninë fetare, familja konsiderohet një ndër institucionet kryesore sidomos në edukimin e të rinjve me vlerat e tolerancës fetare, diversitetit dhe respektimin e shumëlojshmërisë së identiteteve fetare dhe kulturore. Për të kuptuar më mirë rolin që luan familja nuk është e mjaftueshme të kuptohet sa e rëndësishme është feja brenda familjes. Për këtë arsyе të rinjtë u pyetën rreth rolit që ka luajtur familja e tyre në orientimin fetar dhe praktikimin e fesë. Shumica e të rinjve të anketuar duket se e konsiderojnë mendimin e familjes në vendimet e tyre për zgjedhjet e tyre në lidhje me fenë. Kështu pothuajse 1 në 2 të anketuar shprehen se pavarësisht se preferojnë t'i marrin vetë vendimet në lidhje me fenë megjithatë konsultohen edhe me familjen. Ndërkohë 1 në 5 të rinj deklarojnë se familja luan një rol vendimtar në lidhje me orientimin e tyre fetar (Grafiku 10). Megjithatë një përqindje e konsiderueshme, 35%, deklarojnë se familja nuk luan asnjë rol pasi ata i marrin vendimet në mënyrë të pavarur. Kjo e fundit mund të shpjegohet deri diku edhe me moshën e të anketuarve, e cila shpesht mund të karakterizohet nga një ndjesi pavarësie prej familjes. Këto të dhëna gjithsesi theksojnë rëndësinë që ka familja në edukimin e të rinjve rreth vlerave të harmonisë fetare dhe diversitetit të mendimeve në lidhje me këtë çështje.

10. Familja ka luajtur rol vendimtar në orientimin tim fetar.




Grafiku 10: Rolli i familjes në orientimin fetar të të rinjve.

Diskriminimi dhe mos-diskriminimi fetar në Shqipëri sipas të rinjve Si zgjatim i familjes, komuniteti në të cilin jetojmë ka ndikim të konsiderueshmë në formimin dhe shprehjen e identitetit fetar, si dhe qasjen ndaj diversitetit dhe harmonisë. Një sërë pyetjesh në lidhje me marrëdhënien ndërmjet besimit individual dhe përkatësisë në komunitet e shoqëri iu drejtuani të anketuarve për të kuptuar si e shohin të rinjtë veten përballe shoqërisë në përgjithësi dhe komunitetit që i rrethon.

Trajtimi i barabartë dhe mos-diskriminimi për shkak të përkatësisë fetare duket se është mbizotëruar ndër të anketuarit, pasi shumica dërrmuese (86%) thonë se trajtohen njësoj pavarësish besimit fetar të cilat i përkasin. Kjo shifër është një tregues i mirë i harmonisë fetare për të cilën shoqëria shqiptare njihet edhe përtëj kufijve të vendit, një rol që shpesh përdoret si shembull për tu ndjekur në arenën ndërkombëtare. Vetëm 6% e të anketuarve mendojnë se nuk trajtohen në mënyrë të barabartë për shkak të besimit të tyre (Grafiku 11). Megjithëse kjo është një shifër relativisht e vogël, vlen të analizohet edhe më tej cilat janë arsyet e trajtimit ndryshe për shkak të besimit fetar, cila pjesë preket më tepër si edhe cilat janë format e trajtimit ndryshe.

11. Në shoqëri / komunitet trajtohem i njësoj, pavarësish besimit që kemi.




Grafiku 11: Diskriminimi dhe mos-diskriminimi fetar në Shqipëri sipas të rinjve.

Pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete mbi liritë fetare. Vitet e fundit ka një rritje të ndjeshme të aktiviteteve ndërgjegjësuese, ndër të rinjtë, komunitetet rurale e aktivitete kombëtare në lidhje me harmoninë fetare dhe fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Një sërë organizatash të shoqërisë civile shpërndarë në gjithë vendin kanë ndërmarrë iniciativa të ndryshme në 5 vitet e fundit për të adresuar këto fenomene. Për të kuptuar shtrirjen e këtyre aktiviteteve në këtë fushë dhe pjesëmarrjen e të anketuarve në to, një sërë pyetjesh u drejtuani në lidhje me numrin e aktiviteteve të organizuara në komunitete dhe shkolla.

Sa i përket përhapjes së debateve dhe aktiviteteve mbi liritë fetare, pothuajse 40%, shumica e të rinjve, deklarojnë se kanë marrë pjesë në disa raste në aktivitete të këtij lloji. Kjo është një prirje pozitive sa i përket punës që organizatat e shoqërisë civile, shkollat dhe institucionet publike kanë ndërmarrë për të rritur nivelin e informimit dhe për ét nxitur sa

më shumë diskutimin mbi identitetin dhe harmoninë fetare. Megjithatë, duhet shënuar se një pjesë e mirë e të anketuarve, gati 1 në 4 prej tyre, deklarojnë se ende nuk u është dhënë mundësia, pavarësisht gatishmërisë për të marrë pjesë në një aktivitet të tillë. Ndërkokë 31% deklaron se asnjeherë nuk ka marrë pjesë në këto aktivitete (*Grafiku 12*). Këto të dhëna tregojnë se ende ka nevojë për iniciativa të vazhdueshme nga të gjithë aktorët e përfshirë për edukimin e të rinjve në komunitet, për të nxitur jo vetëm kohezionin social, por edhe diskutime më të gjera, përtjerë ambienteve të shkollës, mbi rolin e fesë në shoqërinë shqiptare, karakteristikat e nevojshme për nxitjen e harmonisë fetare, respektimin e lirisë së besimit dhe diversitetin e mendimeve në komunitet.

12. Në komunitetin tim lokal kam marrë pjesë në debate / aktivitete mbi liritë fetare:




Grafiku 12: Pjesëmarrja në aktivitete mbi liritë fetare.

Nevoja për aktivitete ndërgjegjësuese mbi liritë fetare dhe të drejtat e njeriut.

Të pyetur nëse niveli aktual i aktiviteteve në komunitetet e tyre është i mjafueshëm për trajtimin e tematikës së harmonisë fetare, pak më tepër se gjysma deklarojnë se janë të kënaqur me nivelin aktual të angazhimeve në nivel komuniteti. Ndërkokë, 40% thonë se këto aktivitete duhet të shtohen, kurse vetëm 6% mendojnë se ato duhet të pakësohen (*Grafiku 12/1*). Kjo tregon përsëri nevojën për të zgjeruar diskutimet publike mbi përkatësinë fetare, praktikimin e fesë ndër të rinjtë dhe mishërimin e harmonisë fetare për të cilën Shqipëria është e njohur edhe në vende të tjera të botës

12/1. A mendoni se aktivitetet në komunitetin tim që lidhen me liritë fetare dhe me të drejtat e njeriut në përgjithësi:



Grafiku 12/1: Nevoja për aktivitete ndërgjegjësuese mbi liritë fetare dhe të drejtat e njeriut:


A jeni dakord me martesën midis njerëzve të besimeve të ndryshme fetare? Martesat ndërmjet personave nga fe të ndryshme konsiderohet shpesh nga studiuesit e shkencave sociale si "tabuja e fundit" e marrëdhënieve ndërmjet grupeve të ndryshme. Për këtë arsy, qasjet ndaj këtyre martesave shpesh konsiderohen indikatorët më të mirë të integrimit social të grupeve të ndryshme brenda një shoqërie. Ngjashmëria në vlerat dhe besimet fetare e bëjnë një martesë më të mundshme.⁴⁰

Megjithëse mungojnë statistika zyrtare rreth martesave ndërfetare, burime të ndryshme tregojnë se fenomeni është i pranueshëm dhe mendohet të jetë mjaft i përhapur në gjithë vendin. Kombinimi i pluralitetit fetar në vend, bashkë me trajtimin e fesë nën regjimin komunist mund të shpjegojnë traditën e fortë të tolerancës fetare edhe për rrjedhojë, përsë martesat ndërfetare janë të zakonshme.⁴¹ Për shembull, një artikull i vitit 2009 tregon se "*martesat ndërfetare ndërmjet shqiptarëve janë aq të zakonshme sa nuk përbëjnë asnje lajm.*"⁴²

Këto hipoteza reflektohen edhe në gjetjet e anketimit, pasi shumica dërrmuuese e të rinjve, konkretisht 88 % e tyre, deklarojnë se janë plotësisht dakord me martesën ndërmjet dy njerëzve që i përkasin besimeve të ndryshme fetare (88%). Megjithatë, edhe përsë në një masë shumë të vogël nuk duhet shpërfillur që 6% e të anketuarve pohojnë se nuk do të ishin dakord me martesën ndërmjet dy individëve që vijnë nga besime të ndryshme fetare si dhe 6 % e të anketuarve të mbetur kanë preferuar të zgjedhin një pohim neutral lidhur me pranueshmérinë e martesave të tillë duke u shprehur se nuk e dinë.

Rëndësia e besimit në raport me dashurinë për partnerin/en Më tej, të dhënat e studimit tregojnë se 11% e të anketuarve bien dakord se për një partner, feja mund të jetë më e rëndësishme sesa dashuria (*Grafiku 13*). Megjithatë është interesante të vërehet se, 1 në 4 të intervistuar preferojnë të mos i përgjigjen kësaj pyetjeje, çka krijon hapësira për diskutime të mëtejshme rreth arsyeve të kësaj zgjedhjeje. Një arsy e lidhur me këtë rezultat mund të jetë edhe mosha e re e të intervistuarve, të cilët mund të konsiderohen tw rind për të ndërmarrë një hap të tillë si martesa dhe nuk e dinë se si do të reagonin ndaj një vendimi të tillë në të ardhmen. Gjithsesi me shumë se gjysma, ose 64 % e të anketuarve pohojnë se përkatësia fetare nuk është më e rëndësishme se marrëdhëniet ndërpersonale dhe sentimentale ndërmjet dy partnerëve.

13. A jeni dakord ju me martesën midis dy njerëzve që u përkasin dy besimeve të ndryshme fetare:




Grafiku 13: Rëndësia e besimit krahasuar me dashurinë për partnerin/en.

40 Niekerk, V. J. & Verkuyten, M. (2018). *Interfaith marriage attitudes in Muslim majority countries: A multilevel approach*. The International Journal for the Psychology of Religion, 28:4, 257-270, DOI: 10.1080/10508619.2018.1517015

41 Australian Government (2010). *Country Advice: Albania*. Online: <https://www.refworld.org/pdfid/4f40da0b2.pdf> (parë për herë të fundit më 22/06/2019).

42 Likmeta, B 2009, "Albania Muslims Can Wear Headscarf In New IDs", Balkan Insight, 23 January <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/16183/> (parë për herë të fundit më 11/05/2019).


13/1. A mendoni se feja është më e rëndësishme se dashuria për partnerin:



Grafiku 13/1: Rëndësia e besimit krahasuar me dashurinë për partnerin/en.

Roli i fesë dhe të vërtetave të saj. Për të matur dhe vlerësuar qëndrimet e të rinjve në lidhje me tolerancën dhe pranimin e feve të tjera të të anketuarve iu drejtuan një sërë pyetjesh. Së pari, atyre iu paraqitën një sërë pohimesh duke iu kërkuar të zgjidhnin pohimin që i përafrohet më shumë mendimit të tyre. Kështu rezultoi se 1 në 2 të rinj mendojnë se të gjitha fetë çojnë drejt të njëjtit Zot/Perëndie dhe se ndryshimet nga njëra-tjetra janë thjesht rrjedhojë e rrethanave dhe konteksteve në të cilat njerëzit jetojnë (Grafiku 14). Kjo qasje, e cila përfaqëson gjysmën e të rinjve të anketuar, tregon një pikëpamje pluraliste, pranuese dhe përgjithësisht tolerante ndaj besimeve të tjera fetare dhe përgjithësisht tolerante. Grupi i dytë më i madh i të anketuarve beson në dialogun e singertë ndër feve të ndryshme dhe tek aftësia e tyre për të pasuar njëra-tjetrën. Ndërkohë rezulton se rreth 1 në 10 të anketuar (ose 11%) shfaqin një prirje relativisht jo-tolerante, duke shprehur bindjen se "besimi i tyre fetar është e vetmja e vërtetë, në raport me besimet e tjera".

14. Cili prej pohimeve të mëposhtme të përshtatet më shumë?




Grafiku 14: Roli i fesë dhe të vërtetave të saj.

Megjithëse shumica kanë një pikëpamje që përqafon harmoninë dhe tolerancën fetare, ekziston një grup tjetër, prej pothuaj 20% të të anketuarve, që ose e shohin fenë e tyre si të vërtetën e vetme (11%), ose pohojnë se të gjitha fetë e tjera duhet të përbrendësojnë të vërtetën e fesë së përkrahur nga personi i anketuar (9%). Kjo gjetje e bën edhe më të rëndësishme punën me të rinxjtë, për të trajtuar paragjykimet dhe keqinformimet që shpesh zënë vend ndër ta, qoftë kur janë praktikues të besimit të tyre fetar, edhe kur janë besimtarë pasivë të një feje të caktuar. Puna e vazhdueshme me udhëheqës fetarë të të gjitha besimeve në Shqipëri, sidomos ata të moderuar, bëhet edhe më e rëndësishme për të adresuar keqinformimet dhe keqperceptimet që ndonjëherë shfaqen ndër të rinxjtë. Sipas ish-kreut të Komunitetit Mysliman Shqiptar, Z. Skënder Bruçaj, rritja e kapaciteteve të klerikëve myslimanë ka qenë prioritet i këtij institucioni, për të parandaluar përhapjen e çdo lloj deformimi doktrinor të fesë islame në Shqipëri.⁴³ Megjithëse këto të fundit nuk janë kusht i mjaftueshëm për të çuar në radikalizëm dhe eventualisht në ekstremizëm të dhunshëm, janë gjithsesi shenja dalluese të cilat duhen adresuar herët.

Bindjet e të rinjve lidhur me lirinë individuale dhe vlerat fetare. Një tjetër grup pohimesh u vendosën në dispozicion të të anketuarve për të analizuar qëndrimet e tyre në lidhje me zgjedhjet individuale për përkatësinë ndaj një besimi fetar të caktuar. Sikurse mund të shihet nga grafiku më poshtë, shumica dërrmuese e të anketuarve, 71%, besojnë se gjëja më e rëndësishme në jetë është liria individuale dhe se njerëzit duhet të jenë të lirë të besojnë në atë që dëshirojnë. Kjo shifër reflekton përhapjen vlerave të tolerancës dhe harmonisë fetare që mbizotëron në Shqipëri. Më tej, një tjetër grup i konsiderueshëm prej 16% mendon se njerëzit jo domosdoshmërisht duhet të jetojnë sipas disa vlerave ngushtësisht fetare. Megjithëse jo në numër të lartë, një grup të anketuarish mendojnë se njerëzit nuk mund të ndjekin të gjitha parimet e lirisë individuale, por duhet të ndjekin më tepër parimet e një teksti të shenjtë (13%) duke respektuar në të njëjtën kohë edhe bindjet fetare të të tjerëve (Grafiku 15). Megjithëse nuk kemi një bazë krahasuese ndër vite për të parë nëse ka ndryshime në përqindjen e atyre që mendojnë në këto terma, mund të thuhet se luhatjet në marrëdhëniet e shqiptarëve me fenë që prej rënies së sistemit komunist, reflektojnë rritjen e përqindjes së atyre që do të preferonin të ndiqnin parimet fetare duke sakrifikuar aty ku është e domosdoshme parimet e lirisë dhe zgjedhjes individuale.

15. Me cilin prej pohimeve të mëposhtme identifikohemi më shumë?




Grafiku 15: Bindjet e të rinjve lidhur me lirinë individuale dhe vlerat fetare.

43 Intervistë me Z. Skënder Bruçaj, Teolog dhe Pedagog në Universitetin Bedër, ish-Kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Sfidat e të rinjve në komunitet. Problemet me të cilat përballen të rinjtë, si në zona rurale, ashtu edhe në ato urbane, janë të shumëllojshme dhe përbëjnë sfidë jo vetëm për politikëbërje por edhe ë zgjidhjen e tyre në praktikë. Të pyetur se cilat janë çështjet më shqetësuese me të cilat ata përballen në komunitet, në masën më të madhe, të rinjtë e anketuar identifikojnë vështirësitë ekonomike si shqetësimin më të madh. Në fakt, 1 në 2 të anketuar mendon se ky është problemi më i madh që ata kanë. Në vend të dytë, por ngushtësisht e lidhur me shqetësimin e parë, renditet mungesa e perspektivës për të ardhmen, që mund të shpjegojë edhe prirjet në rritje vitet e fundit për emigrimin e të rinjve. Ndërkohë, mungesa e një orientimi fetar identifikohet vetëm nga 3% e të rinjve si problem me të cilin ata përballen në komunitetin e tyre (Grafiku 16).

**16. Në opinionin tuaj cila është çështja më e rëndësishme
me të cilën përballen të rinjtë në komunitetin e qytetit / fshatit ku banoni?**



Grafiku 16: Sfidat e të rinjve në komunitet.

Këto gjetje reflektojnë dhe konfirmojnë gjerësisht gjetjet nga raporte e anketime të tjera të kryera me të rinj shqiptarë në nivel kombëtar. Kështu, një studim mbi rrininë shqiptare i kryer në vitin 2018 tregon se të anketuarit janë më pesimistë për të ardhmen e vendit dhe shoqërisë në përgjithësi. Një në 2 të anketuar presin që situata të përmirësohet, megjithatë 23% mendojnë se asgjë nuk do të ndryshojë, kurse 15% mendojnë se gjërat do të përkeqësohen. Ngjashëm me gjetjet e këtij sondazhi, problemet kryesore të identikuara nga të rinjtë përfshijnë frikën e të qenët i varfër, i papunë dhe i ndikuar negativisht nga korrupzioni.⁴⁴ Pesimizmi në lidhje me perspektivën për të ardhmen dhe vështirësitë ekonomike të identikuara në këtë anketë, në përgjithësi, reflektohen edhe në gjetje të tjera nga studime të kryera për të rinjtë.⁴⁵

44 Çela, A. & Kamberi, G. (2019). *Rinia Shqiptare 2018/2019*. f. 18. Online: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> (parë për herë të fundit më 24/06/2019)

45 Qëndresa Qytetare (2019). *Sondazh kombëtar mbi sjelljet dhe çështjet e të rinjve mbi sistemin politik*. Westminster Foundation for Democracy.


III. EDUKIMI MBI LIRITË FETARE NË SHKOLLA

Edukimi i të rinjve mbi liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, është pjesë fondamentale e procesit të arsimimit në vendet perëndimore, ku sidomos në vitet 2000 dhe në vazhdim një vëmendje gjithnjë e më e madhe i është kushtuar lirive fetare. Nga kjo qasje nuk bën përjashtim as Shqipëria, siç dëshmon vëmendja gjithnjë e më e madhe përfshirë në proceset edukative edhe lirinë e besimit fetar, njohuritë rreth besimeve fetare, etj. Megjithatë, një qasje e tillë ndaj edukimit të të rinjve nuk është studiuar më parë në mënyrë të thelluar. Kësosoj, qëllimi i kësaj pjese të hulumtojë në thellësi perceptimin e të rinjve lidhur me edukimin mbi liritë fetare në shkolla. Kjo është realizuar duke matur: nivelin e aktiviteteve në komunitete; kryesisht në shkollat e mesme dhe universitete (si grupet kryesore të targetuara); lidhur me debatet mbi liritë fetare, iniciativat për promovimin e këtyre lirive; burimet e informacionit të të rinjve mbi besimin fetar; perceptimin e të rinjve për rolin e feve në historinë e vendit dhe identitetin shqiptar; etj.

Trajtimi i barabartë pavarësisht përkatësisë fetare, etnike, socio-ekonomike, etj., në shkollë është domosdoshmëri për çdo shoqëri. Por, përfatë të keq, shpesh këto ambiente kthehen në mbartës të bullizmit dhe diskriminimit përfshirë edhe atë fetare. Për rrjedhojë, trajtimi i barabartë dhe adresimi i fenomeneve negative është thelbësor. Po ashtu, identifikimi i këtyre problematikave në sistemin arsimor është i rëndësishëm për hartimin e ndërhyrjeve efikase.⁴⁶

Trajtimi i barabartë në ambientet shkolllore. Njëri prej seksioneve të pyetësorit përfshirë të rinjtë iu dedikua lirisë së besimit fetar dhe trajtimit të çështjeve të ndryshme që lidhen me fenë dhe të rinjtë. Sikurse mund të shihet nga *Grafiku 17* më poshtë, shumica dérrmuuese e të rinjve të anketuar deklarojnë se në shkollë trajtohen njësoj pavarësisht besimit fetar të cilit i përkasin (91%). Megjithatë, pavarësisht se në përqindje të vogël, ekziston një grup i cili deklaron të kundërtën. Duke pasur parasysh këto të dhëna do të ishte efikase hartimi i iniciativave të targetuara pikërisht përkështetje për këtë grup të rinjsh, përfshirë kuptuar më mirë arsyet e diferençimit, origjinën e tij dhe nga kush vjen trajtimi i diferençuar, nga nxënës të tjera, nga studentë apo nga stafet pedagogjike/akademike dhe për pasoje ndërmarrjen e ndërhyrjeve të ndryshme përmirësimin e një fenomeni të tillë.

17. Në shkollë trajtohem i njësoj pavarësisht besimit që kemi.




Grafiku 17: Trajtimi i barabartë në ambientet shkolllore.

46 Bullivant, S. (2018). *Europe's Young Adults and Religion. Findings from the European Social Survey (2014-2016)*. UK: Benedict XVI Center for Religion and Society.

Liria e shprehjes së bindjeve/besimeve. Në një kuptim më të gjerë të lirisë së besimit fetar, të rinxjtë e anketuar u pyetën rrëth shprehjes lirisht së besimeve dhe mendimeve lirisht në shkollë dhe më gjërësisht në komunitetin e tyre. Nga figura e mëposhtme, mund të vërehet që ka një tkurrje në numrin e të anketuarve që pohojnë tërësisht të sigurt se, nuk ndjehen të paragjykuar kur shprehin identitetin e tyre fetar në shkollë dhe në shoqëri. Kështu 77% e tyre deklarojnë se bien dakord me këtë pohim. Pothuajse një në pesë të anketuar (ose 18%) janë përballur me episode ku janë ndjerë të paragjykuar për shprehjen e një opinioni apo mendimi në lidhje me besimin fetar (*Grafiku 18*). Si rrjedhjë, ky grup deklaron se është pjesërisht dakord me pohimin se janë të lirë të shprehen në lidhje me besimin e tyre fetar. Në përqindje shumë më të vogël, vetëm 5%, të anketuarit ndjehen plotësisht nën trysni dhe të paragjykuar për shprehjen e mendimeve të tyre sa i përket besimit fetar.

18. Në shkollë dhe në shoqëri mund t'i shpreh lirisht bindjet e mia fetare dhe nuk ndehem i paragjykuar. (A jeni dakord me këtë pohim?)



Grafiku 18: Liria e shprehjes së bindjeve/besimeve.

Zhvillimi i debateve në lidhje me liritë fetare në institucionet arsimore. Pothuajse gjysma e të rinxjte të anketuar shprehen se kanë zhvilluar të paktën një aktivitet ose debat mbi liritë fetare në ambientet shkollore. Madje, 8% e tyre deklarojnë se kjo gjë ndodh rëndom në ambientet e tyre shkollore, duke treguar kështu një fokus të shtuar në vitet e fundit në tematikën e fenomeneve të tilla si bullizmi, radikalizmi dhe ekstremizmi fetar në Shqipëri. Gjithsesi një numër jo i paktë, 32%, deklarojnë se nuk kanë pasur asnjëherë aktivitete të tilla në shkollën e tyre, ose nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të ngjashme (*Grafiku 19*). Nga ana tjetër një numër jo i vogël prej 14% pohon se nuk është në dijeni të zhvillimit të aktiviteteve të tilla në shkollë, duke nënkuptuar edhe mungesën e pjesëmarrjes në to.

Trajtimi i çështjeve të besimit fetar konsiderohet përgjegjësi e rëndësishme e shkollave në vazhdën e përgatitjes së të rinxjve për të jetuar në shoqëri ku ka diversitet mendimi dhe origjine.⁴⁷ Megjithatë, vihet në dukje se nuk duhet injoruar edhe roli i rëndësishëm që luajnë familja dhe organizatat fetare. Këto të fundit kanë gjithashtu përgjegjësi për edukimin e gjeneratave të ardhshme. Ndaj të punuarit së bashku mund të promovojë të kuptuarit reciprok duke trajtuar respektin për të drejtat e individëve.⁴⁸


47 Collins-Mayo, S. (2012). *Youth and Religion. An International Perspective*. Theo-Web. Zeitschrift fur Religionpadagogik, Nr. 11, H. 1, ff. 80-94.

48 OSCE. (2007). *Toledo Guiding Principles on Teaching about Religious Beliefs in Public Schools*. <https://www.osce.org/odihr/29154?download=true> (parë për herë të fundit më 29/06/2019)

Përfitimet e trajtimit të çështjeve fetare në shkolla njihen gjerësisht nga institucionet e ndryshme. Për shembull sipas "Parimeve të Toledos" të përgatitura nga OSBE mbi edukimin e të rinjve për lirinë e besimit fetar, njojuritë për besimet e ndryshme fetare janë të domosdoshme pasi:

- 1- Përforcojnë edhe më tej respektin për liritë dhe të drejtat e gjithsecilit në lidhje me besimin fetar, nxisin qytetarinë demokratike dhe promovojnë diversitetin social duke rritur kështu edhe kohezionin social;
- 2- Kanë potencialin të reduktojnë konfliktet që bazohen te mungesa e informacioneve rreth besimit fetar të të tjera;
- 3- Edukimi mbi besimin fetar është më efikas kur kombinohet me përpjekje për të nxitur respektimin e të drejtave të tjetrit, edhe atëherë kur ka mosmarrëveshje rreth besimeve fetare.⁴⁹

19. Në shkollë kemi zhvilluar debate mbi liritë fetare:



Grafiku 19: Zhvillimi i debatave në lidhje me liritë fetare në institucionet arsimore.


Diskutimet mbi liritë fetare në institucionet arsimore. Në konteksttin e studentëve dhe nxënësve të anketuar për këtë sondazh, diskutimet dhe debatet mbi liritë fetare janë zhvilluar kryesisht në kuadër të lëndëve të tjera shoqërore, në 41% të rasteve. Për 15% e të anketuarve këto diskutime kanë qenë më së tepërmë pjesë e aktivitetave ekstra-kurrikulare, kurse për 37% nuk kanë zhvilluar diskutime të tilla. Duhet evidentuar se vetëm në 7% të rasteve, diskutime të tilla janë zhvilluar në kuadër të një lënde me tematikë fetare, çka përputhet me mungesën aktuale të edukimit fetar si pjesë e kurrikulave mësimore në shkolla (Grafiku 20 në vijim). Kjo tregon edhe natyrën e përkohshme dhe ad-hoc të trajtimit të kësaj çështjeje në shkollat ku është kryer anketimi. Ndërkohë që duket se një përqindje e konsiderueshme e të rinjve janë eksposuar ndaj këtyre aktivitetave, duket se ka ende hapësirë për të trajtuar diskutime mbi liritë fetare në kurrikulën shkollore.

49 Po aty.

Organizimi i diskutimeve dhe debateve mbi këtë tematikë në mënyrë të rregullt mund të ketë edhe përfitime të tjera. Sipas një studimi të universitetit të Stanford, vendosja e edukimit mbi liritë e besimit fetar në kurrikula mund të nxisë disa vlera si bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, që ndikojnë në suksesin e mëtejshëm të studentëve edhe në lëndë të tjera.⁵⁰

Për shkak të ndjeshmërisë së kësaj teme duhet treguar kujdes në organizimin e diskutimeve të rregullta apo hartimin e kurrikulave me lëndë specifike. Kështu, duhet treguar kujdes që këto diskutime të bëhen në mënyrë të drejtë, të saktë dhe bazuar në hulumtime serioze mbi çështjen. Këto diskutime duhen bërë brenda kornizës së respektimit të të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe vlerave civile. Në këtë kuadër, ata që trajtojnë diskutime të tillë në ambientet shkollore duhet të kontribuojnë në një mjedis dhe praktika shkollore që promovojnë mbrojtjen e të drejtave të tjerëve në fryshtë e respektit reciprok dhe kuptimit të ndërsjellë ndërmjet anëtarëve të ndryshëm të komunitetit të shkollës.⁵¹

20. Diskutimet mbi liritë fetare në shkollë janë zhvilluar:




Grafiku 20: Diskutimet mbi liritë fetare në institucionet arsimore.

A duhet të shtohet numri i debateve mbi liritë fetare në institucionet arsimore? Qasja pozitive dhe pranimi i debateve e diskutimeve të rregullta mbi liritë fetare në shkolla nga ana e vetë studentëve dhe nxënësve, lehtëson angazhimin e mëtejshëm, jo vetëm të shkollave, por edhe organizatave të shoqërisë civile, pér trajtimin e kësaj tematike. Kështu shumica e të rinjve të anketuar, 44%, mendojnë se debatet mbi liritë fetare duhen shtuar në kurrikulen ose aktivitetet ekstra kurrikulare. Ndërkohë 15% mendojnë se këto debate nuk duhet të zhvillohen fare në shkollat e tyre, mbështetur nga 9% e të anketuarve që do të dëshironin pakësimin e aktiviteteve të tillë. Nga grafiku i mëposhtëm vlen gjithashtu të vërehet se një përqindje e konsiderueshme, 32%, nuk kanë asnjë ide nëse këto duhen shtuar, pakësuar apo nuk duhen zhvilluar fare (Grafiku 21). Një paqartësi e tillë duhet të mbahet parasysh pasi tregon domosdoshmërinë e diskutimit të hapur me të rinjtë në shkolla rreth përfitimeve nga diskutimet dhe debatet mbi lirinë e besimit dhe përkatësisë fetare.

50 Spector, C. (2018). Religiously engaged adolescents demonstrate habits that help them get better grades, Stanford scholar finds. Stanford Graduate School of Education. <https://ed.stanford.edu/news/religiously-engaged-adolescents-demonstrate-habits-help-them-get-better-grades-stanford-scholar> (parë pér herë të fundit më 29/06/2019)

51 OSCE (2007). *Toledo Guiding Principles on Teaching about Religious Beliefs in Public Schools*. <https://www.osce.org/odihr/29154?download=true> (parë pér herë të fundit më 29/06/2019).


21. Në këndvështrimin tim, debatet mbi liritë fetare si pjesë e të drejtave të njeriut në shkollë:



Grafiku 21: A duhet të shtohet numri i debateve mbi liritë fetare në institucionet arsimore?

A kontribuojnë debatet mbi liritë fetare në harmoninë ndërfetare? Ndërkohë që përfitimet e diskutimeve rreth lirive fetare në shkolla janë të mirë-dokumentuara dhe hulumtuara në vende të ndryshme të botës, grafiku i mëposhtëm tregon një prirje pranuese dhe pozitive të të anketuarve ndaj këtij fenomeni. Pothuajse 40% e të anketuarve mendojnë se diskutimet rreth kësaj tematike ndikojnë në rritjen e njohurive rreth harmonisë ndërfetare dhe ndërkulturore në shkollë, mbështetur po nga e njëjtë përqindje të anketuarish (40%) të cilët mendojnë se përritjen e një rezultati të tillë këto diskutime duhet të zhvillohen në fryshtëzim e duhur. 1 në 10 të anketuar mendojnë se këto diskutime nuk do të ndihmonin, ose nuk e dinë nëse do të ndihmonin, në kuptimin më të mirë të harmonisë ndërfetare dhe ndërkulturore në komunitetin e tyre (Grafiku 22).

22. A kontribuojnë diskutimet rreth lirive fetare në shkolla në rritjen e njohurive tuaja për harmoninë ndërfetare dhe ndërkulturore?




Grafiku 22: A kontribuojnë debatet mbi liritë fetare në harmoninë ndërfetare?

Burimet e informimit të të rinjve përfenë. Burimet e informacionit që të anketuarit kanë për t'u informuar rreth çështjeve të besimit fetar të renditura në grafikun më poshtë tregojnë se, të rinjtë fokusohen së tepërmëti në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët e tyre. Kështu

33% e të anketuarve deklarojnë se informacionet i marrin nëse i diskutojnë me miqtë e tyre. Nga ana tjetër, interneti zë vendin e dytë për nga rëndësia si burim informacioni, me 20% të të anketuarve që përdorin këtë mjet për marrjen dhe shkëmbimin e informacioneve mbi çështjet e besimit fetar. Është për t'u theksuar me shqetësim se shkolla dhe universiteti zënë vendin e fundit në këtë hierarki informacioni. Kështu, vetëm 11% e të anketuarve përdorin shkollën apo universitetin si burimin kryesor të informacionit (*Grafiku 23*). Për shkak se 1 në 5 të rinj e përdorin internetin si burim informacioni, ai shndërrohet në rrezik potencial për keqinformimin fetar të të rinjve ose për manipulimin e tyre dhe radikalizimin e mëtejshëm, duke u ekspozuar ndaj grupeve ekstremiste që e zhvillojnë propagandën e tyre online.

23. Cilat kanë qenë burimet tuaja të informacionit rreth çështjeve të besimit fetar në përgjithësi?




Grafiku 23: Burimet e informimit të të rinjve për fenë.

Përdorimi i paktë i deklaruar i shkollës si burim informacioni duhet të shërbejë për të kuptuar më tej cilat janë hendeqet që duhen mbyllur për ta kthyer shkollën në një arenë diskutimesh të hapura dhe të vlefshme mbi çështjet e përkatësisë fetare. Sikurse është analizuar më herët përgjatë këtij kapitulli roli i shkollës dhe mjedisit akademik është tepër i rëndësishëm për nxitjen e vlerave të respektimit të të drejtave të njeriut dhe harmonisë fetare ndër të rinjtë.⁵² Për rrjedhojë, hartimi i aktivitetave novatore në mjediset e shkollave dhe universitetave do të ndikonte në rritjen e rëndësise së këtij institucioni për diskutimin e çështjeve të besimit fetar, pasi sikurse shihet edhe nga grafiku më poshtë, në përgjithësi, interneti është një nga format më të zakonshme dhe të përdorura ndër të rinjtë. Në raport me internetin dhe marrëdhëniet ndërpersonale me të tjerët, renditja e medias si burim informacioni mbetet e dobët, me vetëm 14% të të anketuarve të cilët pohojnë se përdorin këtë mjet për të marrë dijeni për çështje të ndryshme të besimit fetar.

Niveli i informimit të të rinjve rreth besimeve fetare. Bazuar në një vlerësim individual të nivelit të njohive, shumica e të anketuarve (një në dy) ndjejnë se kanë informacion të mjaftueshëm mbi besimet fetare në përgjithësi. Një pjesë e konsiderueshme prej 34%, kanë informacion të pjesshëm, që tregon edhe nevojën për më tepër përpjekje të targetuara ndaj aktivitetave dhe diskutimeve mbi lirinë e besimit fetar dhe tematikave që lidhen ngushtësisht me të. Ndërkohë, një pjesë më e vogël konsideron se ka mungesë informacioni tërësisht apo ka informacion të plotë lidhur me besimet fetare, ku prevalon kjo e fundit. (*Grafiku 24*).

52 UNESCO. 2008. Learning to live together: An intercultural and interfaith program for ethics education. <http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001610/161059E.pdf>. Gjithashtu shih Thorup, C. (2003). *What Works in Building Tolerance Among Balkan Children and Youth*. International Youth Foundation & Balkan Children and Youth Foundation.

24. Në gjykimin tuaj, sa informacion keni për besimet fetare?



Grafiku 24: Nivel i informimit të të rinjve rreth besimeve fetare.

Feja është pjesë integrale e jetës së të rinjve, megjithëse në nivele të ndryshme. Veçanërisht për të rinjtë që janë aktivë në komunitet ose përmes shoqërisë civile është shumë e rëndësishme të jenë të mirinformuar mbi çështjet e besimit fetar.⁵³ Duke pasur parasysh pluralizmin e besimeve fetare njohja e karakteristikave, praktikave dhe ritualeve të besimeve të ndryshme fetare është tepër efikase dhe e rëndësishme për informimin e të rinjve dhe komunitetit në përgjithësi. Për më tepër, një nivel ndjeshmërie ndaj diversitetit fetar në një grup të caktuar mund të krijojë një qasje pozitive dhe motivuese dhe të nxisë kuriozitetin e të rinjve ndaj praktikave të ndryshme fetare dhe besimeve të të tjerve. Kjo mund të ndihmojë në promovimin e respektit të ndërsjellët dhe nivlet të kuptueshmërisë, duke ndihmuar njëkohësisht në tejkalimin e paragjykimeve që lidhen me besimet fetare të ndryshme.⁵⁴


Roli i besimeve fetare në shoqërinë shqiptare. Nëpërmjet perceptimeve të të anketuarve u testua edhe parimi i gjithpranuar se Shqipëria është model për t'u ndjekur në lidhje me harmoninë dhe bashkekzistencën fetare ndërmjet grupeve të ndryshme.

Të anketuarit u pyetën nëse janë ose jo dakord me pohimin se në Shqipëri, besimet fetare kanë shërbyer për të krijuar një kulturë paqeje dhe mirëkuptimi reciprok në Shqipëri. Të dhënat nga grafiku i mëposhtëm (Grafiku 25) tregojnë se shumica e të anketuarve janë dakord me këtë deklaratë. Kështu 40% prej tyre janë dakord, ndërsa 27% janë plotësisht dakord. Vetëm 9% e të anketuarve nuk janë dakord me këtë pohim. Eksportimi i këtyre parimeve nga Shqipëria në vende të tjera duket se ka pasur ndikim edhe në perceptimin e të rinjve mbi harmoninë dhe kulturën e paqes në vend. Nxjerra në pah e shembullit të Shqiperisë si praktikë e mire e harmonisë fetare nga mediat kombëtare dhe ndërkombëtare **mund** të ketë pasur ndikim në perceptimin e të rinjve mbi këtë harmoni. Një pikëpamje e tillë krijon hapësira për nxitjen e diskutimeve të hapura dhe debateve mbi përkatësinë fetare dhe lirinë e besimit fetar në mjetet shkollore në vend.

53 Turjacanin, V. & Zezelj, I. & Maloku, E. & Brankovic, M. (2017, Shtator). *Taming Conflicting Identities: Searching for Youth Values in the Western Balkans*. Në *Changing Youth Values in Southeast Europe: Beyond Ethnicity*. Trost, T. P. & Mandic, D. (edt.), Oxford, UK: Routledge, ff. 151-176.

54 Council of Europe. *Religion and Belief*. <https://www.coe.int/en/web/compass/religion-and-belief> (parë për herë të fundit më 25/06/2019)


**25. Në Shqipëri, besimet fetare kanë shërbyer për të krijuar një kulturë paqeje
dhe mirëkuptimi reciprok në shoqëri.**



Grafiku 25: Roli i besimeve fetare në shoqërinë shqiptare.

Perceptimi i të rinxve mbi bashkëjetesën fetare në Shqipëri. Ekzistanca e harmonisë fetare megjithatë nuk duhet konsideruar e mirëqenë dhe e pandryshueshme. Përkundrazi ruajtja e këtyre balancave kërkon punë të vazhdueshme për t'u siguruar se vlerat e bashkekzistencës dhe harmonisë fetare mbeten të padëmtuara, sidomos ndër të rinxjtë. Për këtë arsyë të anketuarit u pyetën rreth përmirësimit apo përkeqësimit të vlerave të harmonisë fetare në Shqipëri në vitet e fundit. Sikurse mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm (Grafiku 26), rreth 66% e të anketuarve deklarojnë se, këto vlera nuk rrezikojnë të dëmtohen pasi janë thellësisht të rrënjosura në kulturën dhe historinë shqiptare, madje, në 5 vitet e fundit ato janë përmirësuar, (përkatësisht 47 dhe 19% e të anketuarve). Një përqindje e konsiderueshme (24%) nuk kanë një përgjigje për këtë pyetje dhe janë të paqartë për situatën në Shqipëri. Ndërkohë, 10% mendojnë se këto vlera janë përkeqësuar. Megjithëse nuk është një përqindje tepër e lartë, është e rëndësishme të kuptohet më tej si dhe pse sipas një pjese të të rinxve këto vlera janë përkeqësuar. Këtu, edukimi më i mirë mbi çështje të lirisë së besimit fetar do të mund të ndikonte në informimin dhe krijimin e një ideje më të qartë në lidhje me situatën e harmonisë dhe bashkekzistencës fetare në vend.

26. A mendoni se harmonia dhe bashkekzistenca fetare në Shqipëri:




Grafiku 26: Perceptimi i të rinxve mbi bashkëjetesën fetare në Shqipëri.

IV. RADIKALIZIMI DHE EKSTREMIZMI MIDIS TË RINJVE

Perceptimi i të rinjve mbi ekstremizmin dhe radikalizmin. Sa i takon në mënyrë specifike kuptimit që kanë ndërtuar të rinjtë lidhur me ekstremizmin, rezulton se një në katër të rinj nuk e kuptojnë dallimin midis ekstremizmit dhe radikalizmit, ndërsa rreth 75% prej tyre e kuptojnë plotësisht ose pjesërisht këtë ndryshim (*Grafiku 27*). Kjo dëshmon se pavarësisht iniciativave të shumta lidhur me ndërgjegjësimin e të rinjve rreth këtyre fenomeneve, ende një pjesë substanciale e tyre nuk arrin ta kuptojë siç duhet fenomenin. Megjithatë, kjo mund lidhet gjithashtu me interesin e vogël që të rinjtë shfaqin për disa tematika që mund t'i konsiderojnë dytësore mes sfidave dhe problematikave të përditshme që ata hasin. Një problematikë e tillë haset edhe në analizat e organizatave ndërkombëtare, të cilat priren të përdorin një qasje krahasimore në raport me këtë çështje, si OSBE.⁵⁵

27. A jeni dakord me pohimin: “Bazuar në informacionet që kam, e kuptoj dallimin midis ekstremizmit fetar dhe radikalizmit fetar.”




Grafiku 27: Perceptimi i të rinjve mbi ekstremizmin dhe radikalizmin.

Roli i bisedave mes të rinjve për besimin fetar. Sa u takon diskutimeve mes të rinjve, rezulton se feja nuk zë një vend të rëndësishëm në diskutimet mes tyre, apo më gjërësisht në diskursin e të rinjve në institucionet arsimore. Rreth 60% e të anketuarve pranojnë se nuk diskutojnë shpesh me miqtë e tyre për çështje të fesë, aq më pak për t'i bindur ata të konvertohen në besimin e tyre (*Grafiku 28 më poshtë*). Ky është një rezultat i pritshëm, nisur nga indiferentizmi i përgjithshëm i shfaqur nga të rinjtë për çështjet e besimit fetar dhe nga mungesa e nxitjeve për të diskutuar rreth tyre, përvèçse në kuadrin e qasjeve historike ndaj harmonisë dhe bashkekzistencës fetare në Shqipëri. Megjithatë, 1 në 10 të rinj (ose 12% e tyre) pranojnë se shfaqin interes më të madh për diskutime mbi besimin fetar, ose kanë tentuar të bindin miqtë e tyre për të përqafuar bindjet e tyre. Ky tregues mund të rezultojë shqetësues pasi përpjekja për të bindur të tjerët mbi epërsinë e një besimi të caktuar fetar është një ndër shenjat e pranisë së bindjeve/ideve radikaliste fetare. Raste të tillë përfshijnë rekrutimin e të rinjve në ekstremizëm të dhunshëm dhe nxitjen e tyre për të ndërmarrë veprime kundër rendit ligjor e kushtetues të një vendi, ose për t'i nxitur ata t'u bashkohen luftimeve në vende të tjera, çka në të dy rastet përbën vepër penale, pas ndryshimeve në Kodin Penal (shih më lart).

⁵⁵ Shih OSCE (2015). *Working with Youth for Youth: Protection against Radicalization*. Belgrade, Serbia.

28. A jeni dakort me pohimin: "Në shkollë diskutoj shpeshherë me shokët/shoqet lidhur me çështje të fesë dhe përpiqëm t'i bind ata/ato të konvertohen në fenë time."




Grafiku 28: Roli i bisedave mes të rinjve për çështje të besimit fetar.

Shfaqja e veshjeve fetare në shkolla, universitete apo institucionë të tjera publike.

Një tjetër pyetje mbi tolerancën fetare të të rinjve dhe raportin që ata kanë me institucionet, lidhet me qëndrimin e tyre ndaj veshjes fetare në shkolla, universitete dhe institucionë të tjera publike (Grafiku 29 më poshtë). Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vendet perëndimore, ky ka qenë një prej debateve më të nxehtha gjatë dy-tre dekadave të fundit, që ka përfshirë jo vetëm grupe interesit, por edhe institucionë, intelektualë dhe parti politike. Ky debat në disa shtete ka përfunduar me ndryshime legislative që kanë vendosur edhe kufizime për veshje të caktuara fetare. Të tilla mund të përmenden aktet për ndalimin e perçes për gratë në disa vende perëndimore, si dhe ndalimi i disa riteve fetare në universitet në Francë.

29. A jeni dakord që në shkolla, universitete apo institucionë të tjera publike të ketë rregullore që ndalojnë paraqitjen me veshje fetare (shaminë në kokë, varëse me kryq, kapele apo rite të tjera fetare)?




Grafiku 29: Shfaqja e veshjeve fetare në shkolla, universitete apo institucionë të tjera publike.

Në Shqipëri, 56% e të rinxhve të anketuar, nuk janë dakord me praninë e rregulloreve të posaçme që ndalojnë paraqitjen me veshje fetare në institucionet arsimore apo publike në përgjithësi, çka dëshmon një shkallë relativisht të lartë tolerance ndaj pjesës besimtare të popullsisë. Megjithatë është e vështirë të arrihet në përfundimin nëse kjo tolerancë është e përnjëmendtë, apo nëse ajo buron nga indiferentizmi i të rinxhve lidhur me ndjeshmëritë fetare të komuniteteve të caktuara. Nga ana tjetër, pothuajse një në tre të rinxhve (ose rreth 34%) shprehen plotësisht ose pjesërisht në favor të rregulloreve të tillë, çka tregon se rreziku i përhapjes së intolerancës fetare mund të rritet në të ardhmen, në raport me intensitetin e pranisë së këtyre çështjeve në diskursin publik e mediatik.

Prania e radikalizmit fetar në shkollë/universitet. Të pyetur lidhur me praninë e radikalizmit fetar në institucionet arsimore, rezulton se 46% e të rinxhve (ose afërsisht gjysma e tyre) nuk dinë t'i përgjigjen pyetjes (*Grafiku 30 më poshtë*). Kjo në radhë të parë tregon se ka një mungesë të theksuar informacioni lidhur me këtë çështje mes të rinxhve. Gjithashtu, një e dhënë e tillë dëshmon se fushatat mediatike dhe diskursi publik, i intensifikuar gjatë viteve të fundit, nuk kanë dhënë efektet e duhura në drejtim të ndërgjegjësimit të opinionit publik, sidomos të rinxjtë, lidhur me llojin dhe shenjat e fenomenit. Nga ana tjetër, mund të argumentohet se fushatat e ndërgjegjësimit të organizatave të shoqërisë civile, ndonëse janë shumëfishuar vitet e fundit, janë ende larg arritjes së rezultateve të konsoliduara lidhur me identifikimin e shenjave të radikalizmit fetar. Kjo vlen sidomos për institucionet arsimore, ku është përqendruar vitet edhe vëmendja e shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore.

30. A keni dijeni të zhvillimit të radikalizmit fetar në shkollën (apo universitetin) tuaj?




Grafiku 30: A keni dijeni për praninë e radikalizmit fetar në shkollën/universitetin tuaj?

Nga ana tjetër, 45% e të intervistuarve shprehen se nuk kanë dijeni të pranisë së këtij fenomeni në institucionet e tyre arsimore, ndërsa vetëm 1 në 10 (ose rreth 9% e të anketuarve) kanë dijeni për praninë e këtij fenomeni. Treguesi i fundit, ndonëse i vogël, është shqetësues dhe ka nevojë për hulumtim më të thelluar dhe të targetuar, për të kuptuar nëse të rinxjtë e kanë kuptuar apo keq-perceptuar praninë e shenjave të radikalizmit fetar mes të rinxhve, si dhe për të identifikuar "pikat e nxehta".

Perceptimi i të rinjve për shkallën e rrezikut nga radikalizmi dhe ekstremizmi. Një në katër të rinj (ose rrëth 23% e të intervistuarve) shprehen se radikalizmi fetar nuk përbën aspak problem ose sfidë për komunitetin ku jetojnë, duke e klasifikuar rrezikun prej tij me "1" në një shkallë nga "1" në "10". Gjithashtu 16% shprehen se shqetësimi është mesatar, ose i klasifikuar me "5", ndërsa vetëm 3% shprehen shumë të shqetësuar rrëth pranisë së fenomenit në komunitetet e tyre. Kjo tregon se ky fenomen është relativisht dytësor, krahasuar me sfidat socio-ekonomike me të cilat përballen sot të rinjtë në Shqipëri, me papunësinë dhe mungesën e perspektivës (sfida që i klasifikojnë në krye të renditjes së rreziqeve/shqetësimeve me të cilat përballen). Gjithashtu, përgjigja për këtë pyetje ndikohet edhe nga mosnjohja e këtyre fenomeneve sikurse rezultoi në grafikun 28. Vihet re se 63% e studentëve të pyetur, ose nuk njojin mirë fenomenet e radikalizmit dhe të ekstremizmit dhe nuk dinë të bëjnë dallimin midis tyre. Për rrjedhojë, ata e kanë të vështirë të perceptojnë shkallën e rrezikut nga përhapja e tyre në shkolla ose universitete. Për këtë vështirësi bindemi edhe kur shikojmë rezultatin e pyetjes në vijim (*Grafiku 31*).


31. Në perceptimin tuaj, a përbën radikalizmi fetar në komunitetin e qytetit/fshatit/rrethit tuaj problem/shqetësim/sfidë? Nëse po, ju lutem klasifikoni përgjigjen tuaj në një shkallë nga 1 në 10 (1 është minimumi dhe 10 është maksimumi).



Grafiku 31: Perceptimi i të rinjve për shkallën e rrezikut nga radikalizmi dhe ekstremizmi.

Njohja për herë të parë e radikalizmit dhe ekstremizmit. Prania e diskutimeve rrëth fenomenit të radikalizmit fetar kryesisht në diskursin publik, është intensifikuar gjatë periudhës 2012-2017 (38% e të anketuarve pranojnë se kjo është periudha gjatë së cilës kanë dëgjuar për herë të parë për këtë fenomen). Kjo periudhë përkon me konfliktet në Siri dhe Irak, informacionet për të cilat ishin të pranishme në të gjitha mediat, bashkë me problematikën që përcollë bashkimi i disa shqiptarëve në këto luftime. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme (36%) nuk kanë dëgjuar më parë rrëth këtij fenomeni ose nuk e njojin atë (*Grafiku 32 më poshtë*), çka përputhet me përgjigjet e tyre sa i takon njohjes së çështjes (në *Grafikun 28*).

32. Kur keni dëgjuar për herë të parë për praninë e këtij fenomeni në mjedisin tuaj shoqëror apo në komunitetin tuaj?



Grafiku 31: Kur keni dëgjuar për herë të parë për radikalizmin dhe ekstremizmin?

V. GJETJE, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundime

Harmonia dhe bashkekzistenca ndërfetare, e kuptuar si mirëkuptim dhe bashkëjetesë paqësore, mund të konsiderohet një prej tre vlerave më të spikatura kulturore të shoqërisë shqiptare, krahas mikpritjes dhe besës, jo vetëm nga pikëpamja historike, por edhe në epokën e sotme. Modeli i bashkëjetesës paqësore dhe harmonisë ndërfetare në Shqipëri ka shërbyer si shembull dhe vlerë identifikuese e shoqërisë shqiptare dhe si pjesë e identitetit kulturor e social shqiptar. Tradita e bashkëjetesës paqësore ndërfetare midis shqiptarëve, si një vlerë që vjen në epokën e sotme përmes një procesi formimi shumë-shekullor, nuk mund të konsiderohet e mirëqenë, por duhet ruajtur e kultivuar si një e mirë kombëtare.

Megjithëse një pjesë e mirë e të rinxve shqiptarë ende identifikojnë me një besim fetar, ka një prirje në rritje të atyre që deklarojnë se nuk i përkasin asnjë besimi fetar. Kjo tendencë e të rinxve shqiptarë përpunohet edhe me prirjen që shfaqet në nivel Evropian. Megjithatë, identifikimi me një besim të caktuar fetar nuk pasqyron doemos raportin e një individi me atë besim fetar.

Bashkimi Evropian ka nxitur promovimin e tolerancës fetare dhe respektimin e të drejtave themelore të shprehjes dhe ndjekjes së identitetit fetar.⁵⁶ Megjithatë, për shumë shtete, përfshirë edhe Shqipërinë, aplikimi i tyre në realitet nuk është gjithnjë i suksesshëm. Për këtë arsyesh promovimi i të drejtës së besimit fetar kërkon ndërhyrje të institucioneve vendimmarrëse. Një ndër këto ndërhyrje të sanksionuara në udhëzimet e BE-së është edhe thirrja që u bëhet vendeve për të promovuar përmes sistemit arsimor respektin për diversitetin dhe kuptimin e ndërsjelltë duke inkurajuar njoħuri më të gjera mbi diversitetin e besimeve fetare brenda juridikzionit të tyre.

- Të dhënat në këtë studim tregojnë se shumica dërrmuese e të rinxve besojnë se të gjithë qytetarët e Shqipërisë i kanë të garantuara liritë fetare.
- Përsa i takon rolit të familjes në orientimin fetar, 1 në 5 të rinx deklarojnë se ajo ka luajtur rol vendimtar në lidhje me këtë. Këto të dhëna theksojnë rëndësinë që ka familja në edukimin e të rinxve rrëth vlerave të harmonisë fetare dhe diversitetit të mendimeve në lidhje me këtë çështje.
- Përsa i takon mos-diskriminimit për shkak të bindjeve fetare, shumica dërrmuese e të rinxve shqiptarë (86%) pohojnë se trajtohen njësoj pavarësisht besimit fetar të cilat i përkasin. Ky është një tregues i mirë i harmonisë fetare për të cilën shoqëria shqiptare njihet edhe përtëj kufijve të vendit, një rol që shpesh përdoret si shembull për t'u ndjekur në arenën ndërkombëtare.
- Vitet e fundit kanë patur një rritje të ndjeshme të aktivitatave ndërgjegjësuese me përfshirjen e të rinxve të komuniteteve rurale dhe me aktivitete kombëtare në lidhje me harmoninë fetare dhe fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri.

56 Council of the European Union, 2013. EU Guidelines on the promotion and protection of freedom of religion or belief. Online: <https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/137585.pdf> (parë për herë të fundit më 11/05/2019)

- Megjithatë, siç rezulton në sondazh kur të rinxjtë pyeten lidhur me njohuritë e tyre mbi këtë çështje, mosnjohja e fenomenit vijon të mbetet shqetësuese dhe ka ende shumë për t'u bërë.
- Një prej gjetjeve të këtij sondazhi lidhet me shkallën e pranimit të martesave mes besimeve të ndryshme fetare, ku 88% e të rinjve deklaruan se janë dakord ose plotësisht dakord me këtë gjë, çka dëshmon për një shkallë të lartë tolerance dhe respekti të besimeve fetare (ose për një indiferencë lidhur me këtë çështje kur vjen fjala tek çështje si martesa).
- Trajtimi i çështjeve të besimit fetar konsiderohet përgjegjësi e rëndësishme e shkollave në vazhdën e përgatitjes së të rinjve për të jetuar në shoqëri ku ka diversitet mendimi dhe origjine. Për studentët dhe nxënësit e anketuar në këtë sondazh, diskutimet dhe debatet mbi liritë fetare janë zhvilluar kryesisht në kuadër të lëndëve të tjera shoqërore, si sociologjia, historia, gjeografia, etj.
- Qasja pozitive dhe pranimi i debateve dhe diskutimeve të rregullta mbi liritë fetare në shkolla nga ana e vetë studentëve dhe nxënësve lehtëson angazhimin e mëtejshëm jo vetëm të shkollave por edhe organizatave të shoqërisë civile për trajimin e kësaj tematike.
- Feja është pjesë integrale e jetës së të rinjve, megjithëse në nivele të ndryshme. Veçanërisht për të rinxjtë që janë aktivë në komunitet apo përmes shoqërisë civile është shumë e rëndësishme të jenë të mirinformuar mbi çështjet e besimit fetar.
- Sa i takon në mënyrë specifike kuptimit që kanë ndërtuar të rinxjtë lidhur me ekstremizmin, rezulton se një në katër të rinj nuk e kuptojnë dallimin midis ekstremizmit dhe radikalizmit.
- Në Shqipëri, 56% e të rinjve të anketuar, nuk janë dakord me praninë e rregulloreve të posaçme që ndalojnë paraqitjen me veshje fetare në institucionet arsimore apo publike në përgjithësi, çka dëshmon një shkallë relativisht të lartë tolerance ndaj pjesës besimtare të popullsisë. Megjithatë është e vështirë të arrihet në përfundimin nëse kjo tolerancë është e përnjëmendtë, apo nëse ajo buron nga indiferentizmi i të rinjve lidhur me ndjeshmëritë fetare të komuniteteve të caktuara.
- Ekzistenza e harmonisë fetare megjithatë nuk duhet konsideruar e mirëqenë. Përkundrazi ruajtja e këtyre balancave kërkon punë të vazhdueshme për t'u siguruar se vlerat e bashkekzistencës dhe harmonisë fetare mbeten të padëmtuara, sidomos ndër të rinxjtë.

Rekomandime

- Duke identifikuar si një ndër problematikat kryesore të të rinjve njohjen më të thellë të modelit të harmonisë dhe bashkëjetesës paqësore midis komuniteteve fetare në Shqipëri, rekomandohet inkurajimi dhe intensifikimi i aktiviteteve shkollore që synojnë rritjen e vetëdijes rrëth dialogut ndërkulturor dhe ndërfetar, rrëth fenomeneve që lidhen me to, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivele lokale.
- Gjithashtu mbetet një sfidë për të rinxjtë njohja e ligjit për barazinë dhe mos-diskriminimin, sidomos në komponentët që u përkasin mos-diskriminimit dhe barazisë fetare.

- Bazuar në një prej gjetjeve të sondazhit me të rinjtë lidhur me burimet e informimit mbi çështje të besimit fetar, ku interneti përbënte një pjesë thelbësore, rekomandohet përdorimi i fushatave të promovimit të harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në mediat sociale, për të targetuar të rinjtë.
- Ndërtimi i programeve të përfshirjes sociale për pakicat në të gjitha nivelet, duke i kushtuar vëmendje të posaçme të rinjve besimtarë, në mënyrë që të forcohet tek ata ndjesia e përkatësisë dhe barazisë.
- Përdorimi i fushatave të mediave sociale për të sensibilizuar pjesëtarët e rinj të komuniteteve të marxhinalizuara lidhur me parimet e respektimit të lirive të besimit dhe mos-diskriminimit për bindjet fetare.
- Një ndër nevojat afatmesme të të rinjve lidhet me fuqizimin e kapaciteteve të tyre, si dhe të mësuesve e aktorëve të tjera të përfshirë në sistemin arsimtar parauniversitar dhe universitar, për të kuptuar më mirë sjelljet radikalizuese dhe parandalimin në etapat e para që shfaqjes së prirjeve ekstremiste. Bazuar në gjetjet e anketës për kuptimin që kanë të rinjtë rrëth radikalizmit fetar, dhe hendeqet e identikuara në këtë drejtim, lind nevoja që kjo mungesë informacioni dhe njohurish të adresohet përmes një serie trajnimesh të targetuara mbi këto çështje.
- Më tej, në funksion edhe të Planit Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë (2015-2020), sugjerohet ndërmarrja e iniciativave për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve jo vetëm në komunitetet lokale, por sidomos në qeverisjen lokale, duke sjellë modelet dhe shembujt e bashkëjetesës fetare midis të rinjve në vëmendjen e politikëbërësve.
- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në organizatat lokale dhe kombëtare të shoqërisë civile, sidomos përmes iniciativave që fuqizojnë modelet e harmonisë dhe bashkëjetesës midis të rinjve që u përkasin besimeve të ndryshme fetare. Kjo mund të prodhojë në planin afatgjatë rrënjosjen e konceptit të harmonisë dhe bashkëjetesës fetare mes të rinjve aktivistë, duke i shndërruar ata në "*agjentë ndryshimi*", për të promovuar harmoninë ndërfetare brenda komuniteteve të tyre.
- Nga pikëpamja e arsimit, duhet fuqizuar më tej modeli i "Shkollës Qendër Komunitare", duke zgjeruar numrin e tyre dhe duke identifikuar një bërthamë shkollash të tillë sidomos nëpër periferitë e qyteteve të mëdha, ku mund të pilotohen programe/axhenda vjetore aktivitetesh që synojnë rritjen e vetëdijes tek të rinjtë dhe komunitetet lidhur me harmoninë dhe bashkëjetesën paqësore midis besimeve fetare në Shqipëri.
- Përfshirja e të gjithë aktorëve gjatë procesit të formimit të programeve/kurrikulave të përshtatshme për edukimin fetar në shkolla, të tillë si komunitetet fetare, organizatat e shoqërisë civile, etj.
- Ekziston nevoja për të promovuar nëpërmjet sistemit arsimor respektin për diversitetin dhe kuptimin e ndërsjellë, duke inkurajuar zgjerimin e njohurive mbi diversitetin e besimeve fetare brenda juridiksonit shqiptar.

BIBLIOGRAFIA

Libra dhe artikuj:

- Collins-Mayo, S. (2012). *Youth and Religion. An International Perspective*. Theo-Web. Zeitschrift fur Religionpadagogik, Nr. 11, H. 1, ff. 80-94.
- Bullivant, S. (2018). *Europe's Young Adults and Religion. Findings from the European Social Survey (2014-2016)*. UK: Benedict XVI Center for Religion and Society.
- Council of Europe. *Religion and Belief*. <https://www.coe.int/en/web/compass/religion-and-belief>
- Council of the European Union, 2013. EU Guidelines on the promotion and protection of freedom of religion or belief.
- Çela, A. & Kamberi, G. (2019). *Rinia Shqiptare 2018/2019*.
- Azinovic, V. (2018, Qershori). *Understanding Violent Extremism in the Western Balkans*. Regional Report. Extremism Research Forum.
- Berisha, Sh. (2005), "Shqipëria dhe shqiptarët ne veprat e udhëtarëve të shekullit XIX", Tiranë.
- Durham, E. (1990) "Brengat e Ballkanit", Tiranë.
- Hide, E. (2016). Emerging Security Issues: Countering Violent Extremism. Studim strategjik, Qendra e Ekselencës, Tiranë: Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë.
- Hide, E. (2015). Assessment of Risks on National Security. The Capacity of State and Society to react: Violent Extremism and Religious Radicalization in Albania. AIIS, Tirana, Albania.
- Hide, E. (2017). Strengthening Civil Society to Build Youth Resilience to Violent Extremism. Baseline Situation Analysis, Terres Des Hommes, Tirana, Albania.
- Hide, E. & Llubani, M. (2018, July). The Role of Albania's Civil Society in Countering Violent Extremism. Friedrich Ebert Stiftung, Tirana, Albania.
- High Commissioner on National Minorities (1996, Tetor). Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare & sqarime. Hagë: OSCE.
- Huntington, S. (1993, Pranverë). Clash of Civilizations? Foreign Affairs.
- Konica, F. (1905). Letër e Lord Bajronit nga Preveza, 13 Tetor 1809, tek "Udhëtimi i Lord Bajronit në Shqipëri". Shqipëri, Viti 9, Nr. 8.
- Konica, F. (1993). Vepra I. Tiranë: Shtëpia Botuese Naim Frashëri
- Kruja, G. (2017). "Një vështrim sociologjik mbi bashkëjetesën dhe mirëkuptimin ndërfetar tek shqiptarët", në: <http://www.nacionalalbania.al/2017/09/nje-veshtrim-sociologjik-mbi-bashkejetesen-dhe-mirekuptimin-nderfetar-te-shqiptaret/>
- Kruja G. (2008). Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar. Tiranë: Arbëria
- Likmeta, B. (2009). "Albania Muslims Can Wear Headscarf In New IDs", Balkan Insight, 23 January <http://www.balkaninsight.com/en/main/news/16183/>
- Lopez, M. A. & Pasic, L. (2018, Prill). *Youth Work Against Violent Radicalisation. Theory, concepts*

and primary prevention in practice. Strasbourg Cedex: European Commission & Council of Europe.

- Niekerk, V. J. & Verkuyten, M. (2018). Interfaith marriage attitudes in Muslim majority countries: A multilevel approach. *The International Journal for the Psychology of Religion*, 28:4, 257-270, DOI: 10.1080/10508619.2018.1517015
- OSCE (2007). Toledo Guiding Principles on Teaching about Religious Beliefs in Public Schools. <https://www.osce.org/odihr/29154?download=true>
- OSCE (2015). Working with Youth for Youth: Protection against Radicalization. Belgrade, Serbia.
- Popper, K. & Gombrich, E. H. (2013). The Open Society and Its Enemies. Princeton and Oxford: Princeton University Press.
- Qëndresa Qytetare (2019). Sondazh kombëtar mbi sjelljet dhe çështjet e të rinjve mbi sistemin politik. Westminster Foundation for Democracy.
- Sinani, Gj. (2017). Feja dhe edukimi. Tiranë: Friedrich Ebert Stiftung.
- Spector, C. (2018). Religiously engaged adolescents demonstrate habits that help them get better grades, Stanford scholar finds. Stanford Graduate School of Education.
- Thorup, C. (2003). What Works in Building Tolerance Among Balkan Children and Youth. International Youth Foundation & Balkan Children and Youth Foundation.
- Turjicanin, V. & Zezelj, I. & Maloku, E. & Brankovic, M. (2017, Shtator). Taming Conflicting Identities: Searching for Youth Values in the Western Balkans. Në Changing Youth Values in Southeast Europe: Beyond Ethnicity. Trost, T. P. & Mandic, D. (edt.), Oxford, UK: Routledge, ff. 151-176.
- Ulqini, K. (1999). Faktorë kulturorë e fetarë. Shkodër.
- UNESCO. 2008. Learning to live together: An intercultural and interfaith program for ethics education. <http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001610/161059E.pdf>
- Walt, V. D. (2014). Measuring Religious Tolerance in Education. South Africa: North-West University.

Kuadri ligjor dhe strategjik:

- Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 24, pikat 1, 2 dhe 3.
- Ligji 8902 për Marrëveshjen e Republikës së Shqipërisë me Selinë e Shenjtë
- Ligji 9365, mbi procedurat e njohjes së zotësisë juridike të personave juridikë të Kishës Katolike
- Ligji 10056, Marrëveshja me Komunitetin Mysliman të Shqipërisë
- Ligji 10057, Marrëveshja me Kishën Ortodokse
- Ligji 10058, Marrëveshja me Kryegjyshatën Botërore të Bektashinje
- Ligji 10140, për financimin e bashkësive fetare
- Ligji 10349, Marrëveshja me Vëllazérinë Ungjillore të Shqipërisë.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë (2015-2020). Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. <https://arsimi.gov.al/plani-kombetar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020/>
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Neni 18)
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (Neni 9)

Burime elektronike:

- Australian Government (2010). Country Advice: Albania. Online: <https://www.refworld.org/pdfid/4f40da0b2.pdf>
- <http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/shkollat-si-qendra-komunitare&page=23>
- <http://www.instat.gov.al/media/2539/anketa-tremujore-e-forcave-t%C3%AB-pun%C3%ABs-t2-2017.pdf>
- https://treaties.un.org/Pages/DB.aspx?path=DB/studies/page2_en.xml
- <http://www.state.gov/j/ct/rls/crt/2013/224822.htm>
- www.instat.gov.al/al/temat/censuset/censusi-i-popullsis%C3%AB-dhebanesave/#tab2
- European Federation for Intercultural Learning: <http://www.efil.afs.org/>
- Interfaith Youth Core Training Materials: <https://www.ifyc.org/content/interfaith-dialogue-youth-ministry>
- European Interfaith Youth Network: <http://www.eiyn.eu/>
- Youth for a United World resources: <http://y4uw.org/t/interreligious-dialogue/>
- Council of Europe Interreligious Dialogue online resources: <https://edoc.coe.int/en/211-intercultural-and-interreligious-dialogue>
- UNESCO Portal on Interreligious Dialogue: <http://www.unesco.org/new/en/culture/themes/dialogue/intercultural-dialogue/interreligious-dialogue/>

ANEKS

i) Lista e të intervistuarve

LISTA E TË INTERVISTUARVE PËR QËLLIMET KËTIJ STUDIMI NGA KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT:

Fitim Zekthi – Analyst, publicist. Besimtar praktikant i fesë Islame. Pedagog i shkencave politike pranë Universitetit Evropian të Tiranës.

Ahmed Kalaja – Imam, Xhamia e Rrugës së Kavajës, Përfaqësues i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Don Emilio Vale – Zv. Kryetar, Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar, Elbasan. Përfaqësues i komunitetit katolik.

Genti Kruja – Drejtor Ekzekutiv, Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë. Ish Sekretar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Pedagog i Shkencave Islame pranë Universitetit Bedër.

Skënder Bruçaj – Ish Kryetar, Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Elona Mehmeti – Pedagoge e lëndës së Sociologjisë së Fesë, Universiteti Evropian i Tiranës.

Arjola Byzyka – Drejtoreshë, DAR Tiranë (aktualisht Drejtoreshë e Përgjithshme e Arsimit në Bashkinë e Tiranës)

Loreta Aliko – Kryetare, Komiteti Shqiptar i Kulteve

Shkëlqim Sirika – Zv. Drejtor, Gjimnazi “Isa Boletini”, Paskuqan, Kamëz.

Elsa Kerraj – Psikologe shkolle – Gjimnazi “Ibrahim Rrugova”, Kamëz

ii) Pyetësori për Anketën Kombëtare

PYETËSOR: "PROMOVIMI I TOLERANCËS DHE LIRISË FETARE NË SHQIPËRI"

Gjatë vitit 2019 Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), në kuadër të nismës "Promovimi i mirëkuptimit, tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri", me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, do të ndërmarrë një studim mbi lirinë e besimit, tolerancën, harmoninë dhe dialogun ndërfetar, si vlera themelore të shoqërisë shqiptare, duke studiuar rolin që këto vlera mund të kenë për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar tek të rindjtë.

Fryma e tolerancës dhe bashkëjetesa fetare përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar dhe elemente të qarta identitarë kombformues. Ato janë sankzionuar edhe në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si ndër vlerat më të larta të njerëzimit, mbi të cilat ajo bazohet.

Kjo trashëgimi historike është ende sot gjerasisht e pranishme në shoqërinë shqiptare. Megjithatë, në disa raste ajo është vënë përballë sfidave globale si, ekstremizmi fetar, ndaj të cilave Shqipëria nuk mund të jetë e izoluar. Për këtë arsyе është e rëndësishme të analizohet modeli shqiptar i tolerancës, harmonisë ndërfetare dhe lirisë së besimit, si një mekanizëm për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit fetar në Shqipëri. Qëllimi i këtij studimi është analiza e nivelit të tolerancës fetare dhe lirisë së besimit mes të rindje shqiptarë, nëpërmjet një sondazhi kombëtar me të rindjtë, pjesë e të cilit është ky pyetësor. Ai do të pasurohet më tej me të dhëna nga intervista nga aktorë kyçë institucionalë në nivel kombëtar dhe lokalë, politikëbërës në fushën e politikave rinore, përfaqësues të shoqërisë civile të angazhuar me të rindjtë, përfaqësues të komuniteteve fetare, etj.

Të gjitha të dhënat e grumbulluara nga pyetësorët do të administrohen nga KSHH sipas kritereve më të larta të konfidencialitetit dhe nuk do të ndahen me asnjë individ ose organizatë tjeter.

RUBRIKA 1

Informacion i përgjithshëm

1. Cilës grupmoshe i përkisni?

- 15-18 vjeç
- 18-25 vjeç
- 25-35 vjeç
- Mbi 35 vjeç

2. Aktualisht jeni.....:

- nxënës
- student
- aktualisht nuk vazhdoj studime
- Tjetër

3. Statusi juaj i punësimit është...:

- Në punë me kohë të plotë
- Në punë me kohë të pjesshme
- I papunë

4. Gjinia juaj:

- M
- F

5. Qyteti ku jetoni aktualisht:

RUBRIKA 2

Liria e besimit mes të rinjve në familje dhe komunitet

6. A i përkisni një besimi të caktuar fetar? (Kjo pyetje bazohet në vetëdekclarimin tuaj vullnetar dhe në bindjet tuaja individuale.)

- Jo, asnjë besimi
- Po, besimit Ortodoks
- Po, besimit Katolik
- Po, besimit Islam
- Po, tjetër (ju lutemi specifikoni _____)



7. Sa shpesh e praktikoni besimin tuaj fetar?

- Çdo ditë.
- Të paktën një herë në javë.
- Të paktën një herë në muaj.
- Vetëm në rastet e ditëve të shënuara fetare.
- Nuk e praktikoj.

8. A keni vizituar ndonjëherë objektet e kultit të besimeve të tjera?

- Po, shpesh
- Po, ndonëse shumë rrallë
- Jo, asnëjëherë

9. Sa shpesh i frekuentoni objektet e kultit të besimit tuaj fetar për të kryer ritet fetare?

- Po rregullisht (të paktën disa herë në javë)
- Të paktën një herë në javë
- Të paktën një herë në muaj
- Vetëm në ditët e shënuara fetare.
- Nuk i frekuentoj

10. Në këndvështrimin tuaj, a garantohen liritë fetare për të gjithë qytetarët e Shqipërisë?

- Po
- Pjesërisht po
- Pjesërisht jo
- Jo
- Nuk e di

11. Çfarë roli ka feja për ju personalisht?

- rol shumë të rëndësishëm (më orienton në të gjitha vendimet e jetës sime)
- rol të rëndësishëm (më orienton vetëm në momentet më të vështira)
- rol formal (kryesisht lidhet me festimin e ditëve të shënuara fetare)
- nuk ka rëndësi

12. Çfarë vendi zë feja në familjen tuaj?

- rol shumë të rëndësishëm (diskutojmë rregullisht çështje fetare)
- rol të rëndësishëm (diskutojmë ndonjëherë për çështje fetare)
- rol formal (kryesisht lidhet me festimin e ditëve të shënuara fetare)
- rol të parëndësishëm (nuk diskutojmë thaujse asnëjëherë lidhur me besimin fetar)

13. Familja ka luajtur rol vendimtar në orientimin tim fetar.

- Po, ka luajtur rol vendimtar.
- Jo, nuk ka luajtur asnjë rol. I kam marrë gjithnjë vendimet në mënyrë të pavarur.
- Preferoj t'i marr vetë vendimet lidhur me bindjet e mia fetare, politike dhe kulturore, por konsultohem edhe me familjen.

14. Në shkollë trajtohemi njësoj, pavarësisht besimit që kemi.

- Po
- Jo
- Nuk e di

15. Në shkollë dhe në shoqëri mund t'i shpreh lirisht bindjet e mia fetare dhe nuk ndjehem i paragjykuar. (A jeni dakord me këtë pohim?)

- Jam plotësisht dakord me pohimin e mësipërm. (Ndjehem plotësisht i lirë për t'i shprehur bindjet e mia fetare në shkollë dhe shoqëri. Nuk ndjehem aspak i paragjykuar.)
- Jam pjesërisht dakord (Ndjehem pjesërisht i lirë për t'i shprehur bindjet e mia fetare në shkollë dhe shoqëri. Ka patur raste kur jam paragjykuar.)
- Nuk jam dakord (Nuk mund t'i shpreh lirisht bindjet e mia fetare në shkollë dhe shoqëri.)
- Ndjehem vazhdimisht i paragjykuar.)

16. Në shoqëri/komunitet trajtohemi njësoj, pavarësisht besimit që kemi.

- Po
- Jo
- Nuk e di

17. Në komunitetin tim lokal kam marrë pjesë në debate/aktivitete mbi liritë fetare:

- Asnjëherë
- Rregullisht
- Në disa raste
- Nuk më është dhënë mundësia

18. A mendoni se aktivitetet në komunitetin tim që lidhen me liritë fetare dhe me të drejtat e njeriut në përgjithësi:

- Nuk janë të mjaftueshme, duhet të shtohen
- Janë të mjaftueshme
- Duhet të pakësohen?



19. A jeni dakord me martesën midis dy njerëzve që u përkasin dy besimeve të ndryshme fetare:

- Po jam dakord.
- Jo nuk jam dakord.
- Nuk e di

20. A mendoni se feja është më e rëndësishme se dashuria për partnerin:

- Jam dakord
- Nuk jam dakord
- Nuk e di / preferoj të mos përgjigjem

21. Nëse partneri/ja i përket një feje tjeter dhe ai/ajo ju kërkon të konvertonit fenë tuaj në fenë e tij apo të saj, a do të pranonit?

- Po
- Jo
- Ndoshta

22. Lexoni pohimin e mëposhtëm: "Një vlerë që nuk rrjedh nga pikëpamja ime fetare dhe botëkuptimi im fetar, nuk mund të jetë udhërrëfyes për jetën time." Më poshtë ju lutemi të zgjidhni një prej opsiioneve:

- Jam plotësisht dakord
- Jam pjesërisht dakord
- Jam dakord
- Nuk jam plotësisht dakord
- Jam plotësisht kundër

23. Cili prej pohimeve të mëposhtme të përshtatet më shumë?

- Besoj se feja ime është e vërteta e vetme dhe se të gjitha të tjerat nuk janë të vërteta.
- Besoj se të gjitha fetë përbajnjë disa të vërteta, por të gjitha fetë e tjera duhet të ndryshojnë në mënyrë që ta shohin të vërtetën ashtu si e sheh feja ime.
- Mendoj se të gjitha fetë çojnë drejt të njëjtit Zot/Perëndi dhe se ndryshojnë nga njëratjetra për shkak të kushteve dhe rrethanave lokale.
- Besoj në dialogun e singertë me të gjitha fetë e tjera, sepse mendoj se feja ime dhe të gjitha fetë e tjera do të pasuroheshin nga eksperiencia të tillë.
- Nuk e di / nuk i përkas ndonjë besimi fetar.

24. Me cilin prej pohimeve të mëposhtme identifikoheni më shumë?

- Besoj se gjëja më e rëndësishme në jetë është liria individuale dhe se njerëzit duhet të jenë të lirë të besojnë në atë që dëshirojnë;
- Besoj se njerëzit nuk mund të ndjekin çdo ide të lirisë individuale, por duhet të pranojnë parimet e një Teksti të Shenjtë. Megjithatë edhe pikëpamjet fetare të tjerëve duhen respektuar.
- Mendoj se një njeri duhet të jetojë dhe të sillet në përputhje me vlera jo ngushtësish fetare.

25. Në opinionin tuaj cila është çështja më e rëndësishme me të cilën përballen të rinjtë në komunitetin e qytetit/fshatit ku banoni? (Zgjidhni vetëm një alternativë.)

- vështirësitet ekonomike (papunësia, varfëria, etj/)
- tjetërsimi/izolimi social
- mungesa e perspektivës për të ardhmen
- niveli i ulët arsimor
- mungesa e pranisë së institucioneve shtetërore
- mungesa e orientimit fetar
- tjetër (specifiko) _____

RUBRIKA 3

Edukimi mbi liritë fetare në shkollë

26. Në shkollë kemi zhvilluar debate mbi liritë fetare:

- Po shpeshherë
- Po në disa raste
- Jo asnjëherë
- Nuk e di

27. Diskutimet mbi liritë fetare në shkollë janë zhvilluar:

- Në kuadrin e lëndës së edukatës fetare
- Në kuadrin e lëndëve të tjera shoqërore
- Në kuadrin e aktivitetave ekstra-kurrikulare
- Nuk kemi zhvilluar diskutime të tillë

28. Në këndvështrimin tim, debatet mbi liritë fetare si pjesë e të drejtave të njeriut në shkollë:

- Duken shtuar
- Duhen pakësuar
- Nuk duhet të zhvillohen
- Asnjë prej pyetjeve të mësipërme / nuk e di



29. A kontribuojnë diskutimet rreth lirive fetare në shkolla në rritjen e njojurive tuaja për harmoninë ndërfetare dhe ndërkulturore?

- Po
- Jo
- Ndoshta (nëse zhvillohen në fryshtësi e duhur)
- Nuk e di.

30. Shkolla ime është ose ka qenë pjesë e iniciativave dhe aktivitetave që kanë promovuar liritë fetare dhe diskutimet që lidhen me këto çështje.

- Po
- Jo
- Nuk e di.

31. Cilat kanë qenë burimet tuaja të informacionit rreth çështjeve të besimit fetar në përgjithësi?

- Interneti në përgjithësi
- Shkolla/universiteti
- Mediat (elektronike dhe e shkruar)
- Diskutimi me miqtë
- Tjetër

32. Në gjykimin tuaj, sa informacion keni për besimet fetare?

- Informacion të plotë
- Informacion të mjaftueshëm
- Informacion të pjesshëm
- Nuk kam informacion

33. Në Shqipëri, besimet fetare kanë shërbyer për të krijuar një kulturë paqeje dhe mirëkuptimi reciprok në shoqëri.

- Plotësisht dakord
- Dakord
- Pjesërisht dakord
- Nuk jam dakord.

34. A jeni dakord me pohimin se: "Një prej tipareve më të rëndësishëm të identitetit kombëtar shqiptar ka qenë harmonia dhe bashkekzistenca midis të gjitha komuniteteve fetare, duke vendosur si prioritet bashkimin kombëtar, përmbi fenë."

- Plotësisht dakord
- Dakord
- Pjesërisht dakord
- Nuk jam dakord.

35. A mendoni se harmonia dhe bashkekzistenca fetare në Shqipëri:

- Nuk rrezikojnë të dëmtohen, pasi ato janë vlera të ngulitura thellë në historinë tonë.
- Është përmirësuar gjatë 5 viteve të fundit.
- Është përkeqësuar gjatë 5 viteve të fundit.
- Nuk e di.

RUBRIKA 4

Radikalizimi dhe ekstremizmi me baze fetare midis të rinjve^{57*}

36. A jeni dakord me pohimin: “Bazuar në informacionet që kam, e kuptoj dallimin midis ekstremizmit fetar dhe radikalizmit fetar.”

- Jam dakord (e kuptoj plotësisht)
- Jam pjesërisht dakord (e kuptoj vetëm pjesërisht)
- Nuk jam dakord (nuk e kuptoj)

37. A jeni dakord me pohimin: “Në shkollë diskutoj shpeshherë me shokët/shoqet lidhur me çështje të fesë dhe përpinqem t'i bind ata/ato të konvertohen në fenë time.”

- Po, jam dakord
- Jam pjesërisht dakord
- Nuk jam dakord
- Nuk dëshiroj të përgjigjem

38. A jeni dakord që në shkolla, universitete apo institucione të tjera publike të ketë rregullore që ndalojnë paraqitjen me veshje fetare (shaminë në kokë, varëse me kryq, kapele apo rite të tjera fetare)?

- Jam dakord
- Nuk jam dakord
- Jam dakord pjesërisht, pasi varet nga natyra e institucionit.
- Nuk dëshiroj të përgjigjem

39. A keni dijeni të zhvillimit të radikalizmit fetar në shkollën (apo universitetin) tuaj?

- Po
- Jo
- Nuk e di

^{57*} Pyetjet e këtij seksioni bazohen mbi informacionin dhe njohuritë paraprake të të rinjve të intervistuar mbi ekstremizmin dhe radikalizmin fetar.



40. Në perceptimin tuaj, a përbën radikalizmi fetar në komunitetin e qytetit/fshatit/rrethit tuaj problem/shqetësim/sfidë? Nëse po, ju lutem klasifikoni përgjigjen tuaj në një shkallë nga 1 në 10 (1 është minimumi dhe 10 është maksimumi).

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

41. Kur keni dëgjuar për herë të parë për praninë e këtij fenomeni në mjedisin tuaj shoqëror apo në komunitetin tuaj?

- 1990-2000
- 2000-2005
- 2005-2012
- 2012-2017
- Nuk kam dëgjuar ndonjëherë/Nuk e di

42. Në perceptimin tuaj, fenomeni i ekstremizmit fetar është rritur apo zvogëluar me kalimin e kohës në komunitetin/shkollën tuaj?

- rritur
- zvogëluar
- nuk e di

43. Në gjykimin tuaj, cilët janë faktorët që ndikojnë në përqafimin e ideve të ekstremizmit fetar nga të rinjtë në Shqipëri?

Ju faleminderit për opinionet tuaja!

